Министерство за образование и наука - Биро за развој на образованието
Ministria e Arsimit dhe Shkencës - Byroja e Zhvillimit të Arsimit
Ministry of Education and Science – Bureau for Development of Education

# BYROJA E ZHVILLIMIT TË ARSIMIT

# PLANI STRATEGJIK 2023-2025

Shkup, janar 2023



*Të nderuar,*

*E drejta për arsim është një e drejtë universale për çdo fëmijë.*

*Duke filluar nga kjo, Byroja e Zhvillimit të Arsimit, sipas kompetencave që ka, i zhvillon politikat arsimore dhe i realizon të gjitha aktivitetet duke ofruar arsim cilësor në vendin tonë për çdo nxënës/nxënëse në veçanti.*

*Plani strategjik i Byrosë së Zhvillimit të Arsimit, për periudhën 2023-2025, ndjek udhëzimet e Strategjisë së zhvillimit të arsimit 2018-2025, Konceptit për arsim fillor, Konceptit për arsimin gjithëpërfshirës dhe të gjitha dokumentet e tjera, mbi të cilat bazohen reformat dhe janë të cilat janë krijuar për të garantuar interesin më të mirë të nxënësve. Të gjitha aktivitetet e Byrosë (hartimi i programeve mësimore, realizimi i trajnimeve, mbështetja profesionale dhe këshilluese e mësimdhënësve, hulumtimet...) janë planifikuar në mënyrë që të sigurojnë mësim cilësor, mësimdhënie të fokusuar tek nxënësit, përfshirjen aktive të tyre dhe zbatimin e metodave inovative në praktikën mësimore. Masat dhe aktivitetet janë të strukturuara në mënyrë që, përmes të gjitha dokumenteve dhe aktiviteteve që u referohen shkollave dhe zbatohen në shkolla, të sigurojnë nxënësit jo vetëm të fitojnë njohuri, aftësi dhe qëndrime lidhur me lëndët/fushat që mësojnë, por edhe t'i aftësojnë ata që të jenë në gjendje t'u përgjigjen sfidave të përditshme të shoqërisë dhe të marrin vendime të drejta për interesat e tyre dhe të shoqërisë në të cilën jetojnë.*

*Arsimi është një nga sektorët që përballet me ndryshime të vazhdueshme, ndryshime në teknologjinë e mësimdhënies, tregun e punës dhe marrëdhëniet sociale. Prandaj, sfida jonë e përbashkët është t'u përgjigjemi ndryshimeve që ndodhin në kohën e duhur, me mekanizmat më efikas dhe pa cenuar cilësinë e arsimit.*

*Një sfidë e veçantë për ne në periudhën e ardhshme është të sigurojmë një zhvillim cilësor profesional të mësimdhënësve, të ofrojmë trajnime përmes të cilëve mësimdhënësit do të marrin dhe/apo do të përmirësojnë kompetencat e tyre dhe do të dinë të përshtaten me kohën e re dhe gjeneratat e reja të nxënësve.*

*Ky dokument është rezultat i punës së përbashkët dhe angazhimit profesional të gjithë punonjësve të Byrosë, duke përfshirë mbështetjen profesionale dhe bashkëpunimin me të gjitha palët e interesit.*

*Shpresojmë që me realizimin e aktiviteteve të planifikuara në Planin strategjik, do ta afrojmë sistemin tonë arsimor me sistemet arsimore të vendeve më të zhvilluara, jo vetëm formalisht, përmes miratimit të dokumenteve cilësore, por edhe në thelb, nëpërmjet zbatimit të tyre në çdo shkollë, e cila do të kontribuojë në ngritjen e cilësisë së arsimit dhe kënaqësinë e nxënësve, mësimdhënësve, prindërve.*

Nr.01-348/2
08.02.2023
Shkup

*U.D. Drejtor*
Zeqirija Hasipi

## PËRMBAJTJA

NOCIONET ....5

1.1. HYRJA ....6
1.2. ANALIZA E GJENDJES ....7
1.2.1. HISTORIKU I BYROSË SË ZHVILLIMIT TË ARSIMIT....7
1.2.2. ANALIZA E GJENDJES AKTUALE ....9
1.2.2.1. ANALIZA SWOT ....10
1.2.2.2. ANALIZA E KORNIZËS LIGJORE....12
1.2.2.3. PËRCAKTIMI I PALËVE TË INTERESIT ....14
1.2.2.4. INFRASTRUKTUARA E DISPONUESHME ....14
1.2.2.5. BURIMET FINANCIARE ....14
1.2.2.6. BURIMET NJERËZORE....15
1.2.2.7. BASHKËPUNIMI ME INSTITUCIONET E TJERA....15
1.3. MISIONI ....17
1.4.VIZIONI ....17
1.5. DETYRAT DHE OBLIGIMET E ORGANIT TË ADMINISTRATËS SHTETËRORE....17
1.6. SPECIFIKA E ORGANIT TË ADMINISTRATËS SHTETËRORE....18
1.7. STRUKTURA E ORGANIT TË ADMINISTRATËS SHTETËRORE ....18
1.8.MARRËDHËNIET ME ORGANET NË PËRBËRJE....24
1.9. PRIORITETET DHE QËLLIMET E ORGANIT TË ADMINISTRATËS SHTETËRORE..24
1.10. RISHIKIM I REZULTATEVE TË ARRITURA NGA VITI 2021....25
1.11. RISHIKIM I REZULTATEVE TË ARRITURA NGA VITI 2022....28
2. PROGRAMI ....30
2.1. PLANI VEPRIMI I PROGRAMIT: ARSIM CILËSOR PARASHKOLLOR, FILLOR DHE I MESËM ....35
3.NDIKIMI NDAJ BURIMEVE NJERËZORE ....48
4. PARIMET E PËRFAQËSIMIT TË DREJTË ....49
5. PARIMET E MUNDËSIVE TË BARABARTA PËR GRATË DHE BURRAT....50
6. ZHVILLIMI I FUNKSIONEVE TË PËRBASHKËTA....51
7. RREZIQET NË NIVEL TË PLANIT STRATEGJIK....56
7.1. RREZIQET NË NIVEL TË PROGRAMIT 1 ....57

## NOCIONET

| | |
|---|---|
| AA | Agjencia e administratës |
| BZHA | Byroja e Zhvillimit të Arsimit |
| QRMV | Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut |
| QSHP | Qendra Shtetërore e Provimeve |
| ISHA | Inspektorati Shtetëror i Arsimit |
| UE | Unioni Evropian |
| MSHIA | Ministria e Shoqërisë Informatike dhe Administratës |
| MASH | Ministria e Arsimit dhe Shkencës |
| MPPS | Ministria e Punës dhe e Politikës Sociale |
| MF | Ministria e financave |
| NPAA | Programi kombëtar për miratimin e ligjit në Bashkimin Evropian |
| UKM | Universiteti „Kirili dhe Metodij“ |
| QATP | Qendra për Arsim Profesional dhe Trajnime |
| ACQUIS | Legjislacioni i akumuluar, aktet ligjore dhe vendimet gjyqësore që përfaqësojnë trupin e ligjit të Bashkimit Evropian |

## 1.1. HYRJE

Plani strategjik i Byrosë së Zhvillimit të Arsimit (në tekstin e mëtejmë: Byroja), organ i administratës shtetërore në përbërje të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës në cilësinë e personit juridik, është hartuar për periudhën 2023-2025 dhe paraqet një dokument strategjik bazë për zhvillim, e cila u bazua paraprakisht në analizën gjithëpërfshirëse të gjendjes në fushën e funksionimit të institucionit.

Analiza e gjendjes, përcaktimi i gjendjes fillestare, si një nga instrumentet për krijimin e politikave, si proces, ndihmoi që në mënyrë individuale dhe në grup të ndërtohet një kuptim i përbashkët i problemeve me rëndësi prioritet, por në të njëjtën kohë për analizë të faktorëve, lëvizjeve dhe trendëve kryesore në fushën e veprimit dhe të punës tonë, me të cilën u përcaktuan prioritetet dhe qëllimet strategjike të Byrosë për periudhën e ardhshme në përputhje me prioritetet dhe qëllimet e Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës.

Gjatë hartimit të planit strategjik, u morën parasysh udhëzimet e përcaktuara në Metodologjinë për planifikim strategjik dhe përgatitjen e programit vjetor të punës së Qeverisë së Republikës se Maqedonisë së Veriut („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr.124/08 dhe 58/18), Udhëzuesin për mënyrën e veprimit të ministrive dhe organeve të tjera të administratës shtetërore në procesin e hartimit të planit strategjik dhe planit vjetor të punës („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr.131/18) dhe Udhëzuesin për mënyrën e veprimit të ministrive dhe organeve tjera të administratës shtetërore në procesin e monitorimit, vlerësimit dhe raportimit të planit strategjik dhe planit vjetor të punës („ Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr.131/18).

## 1.2. ANALIZA E GJENDJES

### 1.2.1. HISTORIKU I BYROSË SË ZHVILLIMIT TË ARSIMIT

Hapi i parë i krijimit të një enti për avancimin e arsimit dhe edukimit u bë në verën e vitit 1955. Konkretisht, më 11 gusht 1955, me Vendim të Këshillit Ekzekutiv të Republikës së Maqedonisë, nr.214 (për fillimin e përgatitjeve për reformën e arsimit në rajonin e RFP të Jugosllavisë), themelohet Enti për avancimin dhe studimin e shkollimit, për kryerjen e shërbimeve arsimore dhe pedagogjike në RP të Maqedonisë.

Enti filloi punën më 1 janar 1956. Kompetenca kryesore e tij ishte përgatitja e materialeve për reformë të arsimit. Këshilli i Arsimit i Republikës së Maqedonisë e kuptoi se është e pamundur të bëhen reforma në arsim pa përgatitje solide të mësimdhënësve dhe trajnim të vazhdueshëm të tyre për të kryer një punë kaq komplekse dhe të rëndësishme shoqërore.

Punonjësit profesionistë të Entit kishin kompetencën për të ndjekur mësimin, për t'u kujdesur për materialin mësimor, për ta vlerësuar atë dhe për të transferuar njohuritë teorike në praktikën mësimore. Që në fillimet e këtij aktiviteti, Enti jep mendime dhe propozime për hartimin e planeve dhe programeve mësimore dhe kujdeset vazhdimisht për zbatimin e tyre në shkolla. Për përmbushjen e këtyre synimeve komplekse u krijuan ekipe ekspertësh që zbatuan ndryshime në shkolla, propozuan masa për përgatitjen profesionale të kuadrit mësimor, studiuan dhe bënë propozime për rinovimin e objekteve ekzistuese dhe ndërtimin e objekteve të reja shkollore.

Krijimi i Entit të parë përkon me fillimin e përgatitjeve themelore dhe intensifikimit të veprimtarive për reformën e parë të arsimit në vitin 1958. Kështu ky shërbim filloi veprimtarinë e tij si organ drejtues në kuadër të Këshillit të Arsimit në RP të Maqedonisë. Në vitin 1960, për shkak të nevojës së ndërtimit të tij dhe orientimit drejt një institucioni të pavarur që do të propozonte masa për përmirësimin e cilësisë së arsimit në të gjitha institucionet arsimore, u miratua Ligji për Shërbimin Arsimor Pedagogjik i RP të Maqedonisë („Gazeta zyrtare e RPM“ nr.16/60). Me të rregullohet veprimtaria e përgjithshme e Entit Republikan për avancimin e shkollimit dhe themelohen ente rajonale edhe në Ohër, Manastir, Prilep, Kavadar, Titov Veles, Tetovë, Berovë, Strumicë, Gostivar dhe Kumanovë.

Entet e asaj periudhe kanë punuar si institucione të pavarura, por në kuadër të organeve të administratës.

Një transformim më domethënës i shërbimit edukativo-pedagogjik ndodhi me Ligjin për organizimin e veprimtarisë për avancimin e arsimit dhe edukimit nga viti 1974. („Gazeta Zyrtare e RSM" nr. 17/74), e cila krijon bazë ligjore për organizimin e një shërbimi cilësor edukativo-pedagogjik, përgjegjës për analizimin dhe studimin e praktikës pedagogjike të mësimdhënësve dhe shkollave në tërë territorin e Republikës së Maqedonisë. Ligji i lartpërmendur, duke pasur parasysh detyrat dhe funksionin, entet ekzistuese të shkollimit nga organe të administratës i transformoi në ente për avancimin e arsimit dhe edukimit.

Në bazë të rezultateve të arritura, periudha nga viti 1974, deri në vitet e nëntëdhjeta (me miratimin e Ligjit për organet e administratës të 28 shtatorit 1990) me të drejtë mund të shënohet si një kohë me të cilën erdhi në shprehje më të madhe kompetenca profesionale e entit.

Në periudhën pas vitit 1990, entet për avancimin e arsimit kaluan fazën më të vështirë të zhvillimit të tyre.

Me Ligjin për organizimin dhe punën e organeve të administratës shtetërore („Gazeta zyrtare e RM" nr. 40/1990), të gjitha entet komunale dhe ndër komunale dhe Enti Republikan për avancimin e arsimit dhe edukimit u bashkuan në një intitucion dhe u formua Enti Pedagogjik i Maqedonisë.

Me këtë transformim u harmonizua zhvillimi i veprimtarisë për avancimin e arsimit në arsimin para universitar të Republikës së Maqedonisë.

Por edhe më drastike janë ndryshimet që rezultuan nga Ligji për organizimin dhe punën e organeve të administratës shtetërore të vitit 2000 („Gazeta Zyrtare e RM" nr. 58/2000) kur Enti pedagogjik e Maqedonisë vazhdoi të punojë si **Byroja e Zhvillimit të Arsimit**, organ në përbërje të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës me cilësi të personit juridik, si bartës i të gjitha reformave të rëndësishme në arsimin parashkollor, fillor dhe të mesëm.

### 1.2.2. ANALIZA E GJENDJES AKTUALE

Byroja e Zhvillimit të Arsimit, si organ në kuadër të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës me cilësi të personit juridik, kryen punë profesionale me rëndësi për zhvillimin dhe avancimin e edukimit dhe arsimit në Republikën e Maqedonisë së Veriut. Prioritetet dhe qëllimet e përcaktuara në Planin strategjik për periudhën 2023-2025 bazohen në rezultatet e analizës së punës së Byrosë, ndërsa aktivitetet e parashikuara në Planin strategjik do të jenë detyrim i të gjithë punonjësve për arritjen e treguesve të përcaktuar të suksesit.

Përpara përcaktimit të prioriteteve strategjike dhe qëllimeve prioritare për periudhën e ardhshme trevjeçare dhe në përgjithësi të planeve për të ardhmen, u qas në përgatitjen e një analize cilësore të faktorëve kyç, kushteve, rrethanave, trendeve dhe lëvizjeve bashkëkohore në fushën e kompetencave të Byrosë në përputhje me misionin e përcaktuar, duke u udhëhequr nga nevoja e konsistencës dhe përputhshmërisë së tyre me prioritetet dhe qëllimet strategjike të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Duke analizuar gjendjen aktuale, në përgjithësi kemi punuar për të gjetur përgjigje për disa pyetje të mëposhtme:

Ku jemi ne si Byro në kontekstin e fushës së veprimtarisë sonë? Cila është situata në zonë? Cilat janë problemet kryesore? Si është natyra dhe ndikimi i tyre? Pse është e rëndësishme zgjidhja e problemit/problemeve si prioritet? dhe Cilët janë palët e interesit të problemit gjegjësisht problemeve?

Me rëndësi kyçe ishte identifikimi dhe përzgjedhja e çështjeve prioritare që prekin Byronë dhe arritja e një pozicioni të harmonizuar në raport me çështjet dhe qëllimet kritike/kryesore.

Gjithashtu është bërë një analizë e burimeve dhe kapaciteteve të përgjithshme financiare dhe njerëzore; përcaktim i kapaciteteve që duhet të përmirësohen/përforcohen; përcaktim i rreziqeve nga mjedisi i brendshëm dhe i jashtëm që mund të kërcënojnë/vështirësojnë arritjen e rezultateve të planifikuara, njëkohësisht duke identifikuar pikat e forta dhe mundësitë/sfidat që i kemi në dispozicion dhe duhet të përdoren.

### 1.2.2.1. ANALIZA SWOT

Në nivel të Byrosë së Zhvillimit të Arsimit është përgatitur analiza SWOT (Strengths, Weaknesses, Opportunities, Threats), si instrument për analizën e gjendjes së institucionit, me të cilën janë përcaktuar përparësitë, dobësitë, mundësitë dhe kërcënimet në interes të funksionimit të mëtejmë të suksesshëm të Byrosë.

Analiza bëri të mundur skanimin e gjendjeve të brendshme, domethënë u përcaktuan të gjitha momentet e rëndësishme në funksionimin e Byrosë, përfaqësimin e interesave të gjitha njësive organizative, si dhe faktorëve nga mjedisi i jashtëm.

Përgatitja e analizës kontribuon në përmbushjen e qëllimeve të mëposhtme:

- zbatimin e analizës funksionale në drejtim përforcimit të kapaciteteve;
- rritjen e nivelit të funksionalitetit dhe efikasitetit të Byrosë;
- identifikimin dhe trajtimin e rreziqeve;
- krijimin e një sistemi adekuat për zbatimin e politikave të duhura dhe koordinimin/komunikimin e duhur;
- forcimin e kapaciteteve institucionale në drejtim të zhvillimit dhe avancimit të edukimit dhe arsimit në Republikën e Maqedonisë së Veriut;
- përcaktimin e drejtimeve të planifikimit strategjik, monitorimin e zbatimit dhe vlerësimin;
- përforcimin dhe konkretizimin e bashkëpunimit institucional me palët e interesit;
- krijimin e një sistemi adekuat për ngritjen e vazhdueshme të punonjësve të Byrosë.

*Tabela: Analiza SWOT*

| PËRPARËSITË | DOBËSITË |
|---|---|
| Njohje e lartë<br>Përshtatje adekuate<br>Rezultate të mira<br>Staf adekuat profesional<br>Gjithpërfshirje<br>Sistem adekuat për transparencë dhe llogaridhënie në punë | Mungesë e hapësirave në pronësi<br>Mungesë e kushteve materiale për punë<br>Mungesë e burimeve njerëzore<br>Teknologji e vjetruar<br>Zhvillim i kufizuar në karrierë |
| **MUNDËSITË** | **RREZIQET** |
| Forcimi i kapaciteteve dha aftësive të punonjësve<br>Rritja e numrit të punonjësve<br>Përmirësimi i kushteve të punës<br>Shkëmbimi i përvojave dhe praktikave të mira me institucione të ngjashme në rajon dhe BE<br>Përmirësimi i perceptimit të institucionit<br>Zgjidhja e marrëdhënieve pronësore-juridike | Largimi i kuadrit<br>Ndryshimet ekonomike (zvogëlimi i fuqisë financiare) të institucionit<br>Numër i reduktuar i ofruesve të shërbimeve<br>Rezistenca ndaj risive<br>Ndryshimet në mjedisin politik |

### 1.2.2.2. ANALIZA E KORNIZËS LIGJORE

Në përcaktimin e prioriteteve dhe qëllimeve, Byroja e Zhvillimit të Arsimit udhëhiqet nga parimet e mëposhtme:

- lidhshmëria e misionit të Byrosë së Zhvillimit të Arsimit me prioritetet dhe qëllimet strategjike të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, rrjedhimisht edhe me prioritetet dhe qëllimet strategjike të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut për vitin 2023 (Vendim për përcaktimin e prioriteteve strategjike të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut për vitin 2023, Gazeta Zyrtare e RMV, nr. 122 datë 30.05.2022), nga Metodologjia për planifikim strategjik dhe përgatitja e Programit vjetor të punës së Qeverisë së Republikës së Maqedonisë, prioritetet dhe qëllimet në Programin kombëtar për miratimin e ligjit në BE, Strategjinë e zhvillimit të arsimit 2018-2025, dinamikën e zbatimit të Konceptit të ri të arsimit fillor të vitit 2021;
- pajtueshmëria e prioriteteve dhe qëllimeve të Byrosë së Zhvillimit të Arsimit me prioritetet dhe qëllimet e Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, si organ i administratës shtetërore në përbërje të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës;
- realizueshmëria reale e prioriteteve dhe qëllimeve të përcaktuara në përputhje me burimet dhe kapacitetet në dispozicion të Byrosë së Zhvillimit të Arsimit;
- maturia e rezultateve përmes një grupi të balancuar dhe relevant të treguesve të suksesit.

Plani strategjik i Byrosë bazohet në:

- Programin e punës së Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut të vitit 2023;
- Vendimin për përcaktimin e prioriteteve strategjike të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut në vitin 2023;
- Programin kombëtar për miratimin e ligjit në Bashkimin Evropian;
- Ligjin për Byronë e Zhvillimit të Arsimit;
- Ligjin për kornizën kombëtare të kualifikimeve;
- Ligjin për Arsim fillor;
- Ligjin për Arsim të mesëm;
- Ligjin për Arsim dhe trajnim profesional;
- Ligjin për Arsimin e të rriturve;
- Ligjin për mësimdhënësit dhe bashkëpunëtorët profesional në shkolla fillore dhe të mesme;
- Ligjin për Mbrojtjen e fëmijëve;

- Ligjin për tekstet shkollore për arsimin fillor dhe të mesëm;
- Ligjin për Shërbimin Pedagogjik;
- Ligjin për Qendrën Shtetërore të Provimeve;
- Ligjin për Inspektoratin e Arsimor;
- Ligjin për Akademinë e Sportit;
- Ligjin për nëpunësit administrativ;
- Ligjin për mundësi të barabarta të grave dhe burrave;
- Strategjinë e arsimit për periudhën 2018-2025;
- Strategjinë e arsimit të rriturve;
- Konceptin për arsim fillor 2021;
- Konceptin për modernizimin e arsimit teknik;
- OECD (2019), OECD Reviews of Evaluation and Assessment in Education: North Macedonia;
- Dhe dokumentet e tjera relevante strategjike kombëtare dhe ndërkombëtare;
- Rregulloren për organizimin e brendshëm të Byrosë së Zhvillimit të Arsimit;
- Rregulloren për sistematizim të vendeve të punës të Byrosë së Zhvillimit të Arsimit.

Sa i përket përmbajtjes, kornizës kohore dhe elementeve të tjera, plani është real.

Gjithashtu, gjatë hartimit të Planit strategjik të Byrosë së Zhvillimit të Arsimit, janë marrë parasysh rezultatet e arritura në vitin 2021 si dhe rezultatet e arritura të vitit 2022, të cilët janë prezantuar në Raportin e realizimit të Planit vjetor të Byrosë së Zhvillimit të Arsimit në vitin 2022, si dhe në analizën dhe vlerësimin e rezultateve të arritura në kuadër të programeve dhe projekteve që u realizuan ne vitin 2022.

### 1.2.2.3. PËRCAKTIMI I PALËVE TË INTERESIT

Me rëndësi të madhe është përcaktimi i të gjitha subjekteve apo grupeve që kanë përfitim apo ndikim të drejtpërdrejtë ose jo i drejtëpërdrejtë nga zbatimi i masave dhe aktiviteteve të planifikuara në Planin strategjik të Byrosë së Zhvillimit të Arsimit.

Gjithashtu, duke marrë parasysh rëndësinë e konsultimit me palët e interesit, si një mekanizëm i rëndësishëm për përmirësimin e cilësisë së punës, Byroja planifikon të vlerësojë nivelin e interesit të palëve të interesit (drejtorë të institucioneve arsimore, edukatorë, mësimdhënës, bashkëpunëtorë profesional, prindër, nxënës) që të parashikojë aspekte të ndryshme në fushën e reagimeve, interesit, pjesëmarrjes dhe sjelljeve të ngjashme lidhur me zbatimin dhe postzbatimin e planit strategjik si dokument zhvillimor strategjik.

### 1.2.2.4. INFRASTRUKTURA E DISPONUESHME

Byroja e Zhvillimit të Arsimit nuk ka objekte të veta për punë (selia e Byrosë në Shkup është në pronësi të Qeverisë ndërsa njësitë rajonale shfrytëzojnë objekte me qira). Është e nevojshme urgjentisht zgjidhja e marrëdhënieve pronësore-juridike të Byrosë.

Burimet materiale që Byroja e Zhvillimit të Arsimit disponon brenda njësive të brendshme organizative: ambiente zyrash të pajisura, linja telefonike, pajisje TIK me internet, sisteme softuerike, sistemi informativ TIK i Byrosë, automjetet, janë në nivel të kënaqshëm.

### 1.2.2.5. BURIMET FINANCIARE

Fondet për financimin e punës së Byrosë së Zhvillimit të Arsimit sigurohen nga:

- buxheti i Republikës së Maqedonisë së Veriut;

- të ardhurat e veta;

- donacionet.

### 1.2.2.6. BURIMET NJERËZORE

Aktualisht, Byroja e Zhvillimit të Arsimit ka gjithsej 148 punonjës.

Selia e Byrosë është në Shkup. Për kryerjen e punëve në kompetenca të Byrosë jashtë selisë, posaçërisht për kryerjen e punës këshilluese profesionale dhe punës udhëzuese-mentoruese të kuadrit arsimor dhe kuadrit drejtues, janë themeluar njësitë rajonale në Shtip, Strumicë, Veles, Кavadar, Кumanovë, Ohër, Prilep, Tetovë dhe Gostivar.

Menaxhimi me punonjësit në Byro është i organizuar në mënyrë strategjike me qëllim që: çdo punonjës individualisht dhe të gjithë së bashku të përpiqen për të arritur qëllimet e përcaktuara, duke rritur efikasitetin e punës dhe kryerjen e detyrave të punës në nivelin më të lartë profesional.

Ekziston një largim shumë i madh i kuadrit profesional përmes pensionimit, largimit në vende të tjera të punës dhe largimit jashtë vendit. Planet vjetore për punësim në të cilat ka propozim për një numër më të madh të punësimeve, sesa për pensionime, në bazë të vendeve të lira në sistematizimin dhe vëllimin e shtuar të punës së Byrosë për zbatimin e reformave në arsim, nuk marrin miratim nga Ministria e Financave. Kjo paraqet një problem serioz në kryerjen e detyrave dhe kompetencave të Byrosë së Zhvillimit të Arsimit.

### 1.2.2.7. BASHKËPUNIMI ME INSTITUCIONET E TJERA

Byroja e Zhvillimit të Arsimit bashkëpunon me institucionet dhe organizatat kombëtare dhe ndërkombëtare:

- Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut;
- Sekretariati i përgjithshëm i QRMV;
- Ministria e Arsimit dhe Shkencës;
- Ministria e Financave;
- Ministria e Ekonomisë;
- Ministria e Punës dhe Politikës Sociale;
- Ministria e Shoqërisë Informatike dhe Administratës;
- Ministria për Sistem Politik dhe Marrëdhënie Ndërmjet Bashkësive;
- Ministria e Punëve të Jashtme;
- Sekretariati për Legjislacion;
- Sekretariati për Çështje Evropiane;
- Qendra për Arsim dhe Trajnim Profesional;
- Qendra Shtetërore e Provimeve;
- Inspektorati Shtetëror i Arsimit;

- Shërbimi Pedagogjik;
- Qendra për Arsimin e të Rriturve;
- Agjencia Kombëtare për Programet Arsimore Evropiane dhe Lëvizshmërinë;
- Kopshtet publike të fëmijëve në RMV;
- Shkollat fillore në RMV;
- Shkollat e mesme në RMV;
- Konviktet e nxënësve në RMV;
- Njësitë e vetëqeverisjes lokale në RMV;
- Zyra e Bashkimit Evropian në RMV;
- Fondi Evropian për Trajnim (ETF);
- Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE);
- Këshilli Britanik;
- Zyra Programore e Këshillit të Evropës në Shkup;
- Banka Popullore e RMV;
- Fondi për Inovacione dhe Zhvillim Teknologjik;
- Banka Botërore e RMV;
- Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit;
- Agjencia për rini dhe sport;
- Universiteti „Cirili dhe Metodij“ (UKM);
- Univesiteti „Goce Dellçev“ – Shtip (UGD);
- Universiteti i Tetovës (UT);
- Fakulteti Pedagogjik „Shën Kliment i Ohrit“ – Shkup;
- Fakulteti Pedagogjik „Shën Kliment i Ohrit“ – Manastir;
- BKU „Shën Klimenti i Ohrit“ - Shkup;
- Qendra Maqedonase për Edukim qytetar (QMEQ);
- Qendra për Të Drejta e Njeriut dhe Zgjidhjen e Konflikteve;
- Fondacioni Shoqëria e Hapur në RMV;
- Fondacioni për Iniciativa Arsimore dhe Kulturore „Hap pas hapi“ - Shkup;
- Fondacioni i Fëmijëve Pestaloci;
- Ambasada e Parë e Fëmijëve në Botë - Megjashi;
- JA Achievement – Macedonia;
- Zyra e UNICEF;
- UNDP;
- UNFPA;
- USAID;
- Korpusi i Paqes i RMV;
- Organizata ndërkombëtare IREKS.

## 1.3. MISIONI

Avancimi dhe zhvillimi veprimtarisë edukative-arsimore në fushën e arsimit parashkollor, fillor, gjimnazit, arsimit artistik, lëndët e përgjithshme në arsimin e mesëm profesional, të specializuar, arsimit të rriturve, të fëmijëve me nevoja të veçanta arsimore, veprimtarisë edukative-arsimore të konvikteve të fëmijëve, si dhe të arsimit të fëmijëve qytetarë të Republikës së Maqedonisë së Veriut në diasporë për mësimin e gjuhës dhe kulturës amtare.

Misionin e saj Byroja e Zhvillimit të Arsimit e realizon përmes krijimit të planeve dhe programeve të reja mësimore, hulumtimeve zhvillimore, këshillimit dhe trajnimit të kuadrit arsimor, ndjekjes së arritjeve të nxënësve, botimit të manualeve, revistave dhe materialeve tjera didaktike në mbështetje të mësimdhënies.

## 1.4. VIZIONI

Sigurimi i arsimit dhe edukimit cilësor për gjeneratat e reja që të fitojnë kompetencat e nevojshme për përfshirje të suksesshme dhe aktive në jetën e përgjithshme dhe në tregun e punës.

## 1.5. DETYRAT DHE OBLIGIMET E ORGANIT TË ADMINISTRATËS SHTETËRORE

Byroja e Zhvillimit të Arsimit në bazë të obligimeve të përcaktuara me ligj kryen detyrat në vijim:

- krijon koncepte për zhvillimin e sistemit edukativ-arsimor, standarde arsimore, plane dhe programe mësimore për arsimin parashkollor, fillor, të mesëm dhe arsimin e specializuar, arsimin e fëmijëve me nevoja të veçanta arsimore dhe për arsimin e të rriturve;

- kryen dhe organizon hulumtime në fushën e arsimit si bazë për zhvillim të politikave arsimore në vend;

- organizon dhe zbaton veprimtari për zhvillim profesional të kuadrit edukativ - arsimor;

- monitoron dhe vlerëson realizimin e punës edukative-arsimore dhe jep mbështetje profesionale – këshilluese për kuadrin edukativ - arsimor;

- harton koncept për tekste shkollore, program për botimin e teksteve dhe metodologji për vlerësim profesional të dorëshkrimeve të teksteve shkollore si dhe për vlerësimin e cilësisë së tyre.

- boton dokumentacionin dhe evidencën pedagogjike për arsimin fillor dhe të mesëm;

- vendos dhe përsos një sistem informacioni-dokumentimi brenda kompetencave të Byrosë së Zhvillimit të Arsimit.

## 1.6. SPECIFIKA E ORGANIT TË ADMINISTRATËS SHTETËRORE

Byroja e Zhvillimit të Arsimit është organ i administratës shtetërore në përbërje të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës në cilësinë e personit juridik.

## 1.7. STRUKTURA E ORGANIT TË ADMINISTRATËS SHTETËRORE

Në kuadër të Byrosë së Zhvillimit të Arsimit janë të institucionalizuara shtatë sektorë dhe tre njësi të pavarura.

➢ **Sektori për zhvillimin e sistemit edukativ-arsimor dhe krijimin e standardeve, planeve dhe programeve mësimore** me kompetencë kyçe për krijimin e koncepteve për zhvillimin e sistemit arsimor, planeve dhe programeve mësimore për arsimin parashkollor, fillor, të mesëm dhe arsimin e specializuar, si dhe arsimin e nxënësve me nevoja të veçanta arsimore dhe arsimin e të rriturve. Për realizimin e kësaj veprimtarie, sektori përgatit analiza dhe organizon diskutime në bazë të cilave përcakton nevojat për zhvillimin e planeve dhe programeve mësimore si dhe të dokumenteve të tjera konceptuale.

Brenda këtij sektori janë institucionalizuar tre njësi:

- Njësia e zhvillimit të sistemit edukativ-arsimor dhe krijimit të standardeve, planeve dhe programeve mësimore në arsimin parashkollor dhe mësimin klasor;
- Njësia e zhvillimit të sistemit edukativ-arsimor dhe krijimit të standardeve, planeve dhe programeve mësimore në mësimin lëndor të arsimit fillor; dhe
- Njësia e zhvillimit të sistemit edukativ-arsimor dhe krijimit të standardeve, planeve dhe programeve mësimore në arsimin gjimnaz, arsimin artistik dhe për lëndët e përgjithshme të arsimit profesional.

➢ **Sektori për hulumtime në arsim** me kompetencë kyçe për të kryer hulumtime, të realizojë hulumtime zhvillimore dhe aksionare lidhur me zhvillimin dhe avancimin e punës edukative-arsimore, të përgatisë plane vjetore për zhvillim të hulumtimit, të organizojë dhe koordinojë punën e ekipeve profesionale të cilët punojnë në hulumtime zhvillimore, të përcjellë realizimin e hulumtimeve dhe t'i informojë shkollat dhe institucionet tjera, të organizojë diskutime profesionale dhe shkencore për hulumtimin e temave dhe problemeve aktuale tek ne dhe në vendet e tjera dhe të nxitë zbatimin e rezultateve të hulumtimit në fushën e arsimit.

Brenda këtij sektori janë institucionalizuar dy njësi:

- Njësia për hulumtim, zhvillim dhe çështje të sistemit; dhe
- Njësia për projekte hulumtuese dhe bashkëpunim ndërkombëtar.

➢ **Sektori për zhvillimin profesional të kuadrit edukativ-arsimor dhe punë profesionale-këshilluese** me kompetencë kyçe për të bërë analiza dhe bazuar në to të përcaktojë nevojat për zhvillim profesional të kuadrit edukativ-arsimor (mësimdhënës, dhe bashkëpunëtorë profesional), të organizojë diskutime tematike lidhur me zhvillimin profesional të kuadrit edukativ-arsimor dhe atij udhëheqës, të përpilojë një plan afatgjatë për nevojat e trajnimit të kuadrit edukativ-arsimor, të hartojë një plan afatgjatë dhe vjetor të aktiviteteve për trajnim të kuadrit edukativ-arsimor, të zbatojë procedurat e akreditimit për ofrimin e shërbimeve lidhur me zbatimin e programeve të trajnimit të kuadrit edukativ-arsimor, si dhe të hartojë metodologji dhe mjete për realizimin e vizitave këshilluese-profesionale, të përgatisë plan vjetor për realizimin e tyre dhe përditësimin e të njëjtave.
Brenda sektorit janë institucionalizuar dy njësi:

- Njësia për zhvillim profesional të kuadrit edukativ-arsimor;
- Njësia për punë profesionale-këshilluese.

➢ **Sektori për veprimtari botuese** me kompetencë kyçe të botojë (në formë elektronike ose të shtypur) plane dhe programe mësimore për arsimin parashkollor, fillor, të mesëm, arsimin e specializuar, arsimin e fëmijëve me nevoja të veçanta arsimore dhe arsimin fillor për të rritur, udhëzime didaktike-metodike për mësimdhënie, doracakë për planifikimin dhe përgatitjen e mësimit, monografi, botime serike, revista shkencore – profesionale, punëtori dhe punime të tjera shkencore e profesionale që kanë për funksion përsosjen, modernizimin, dhe zhvillimin e edukimit dhe arsimit. Krijon përmbajtje digjitale për realizimin cilësor të mësimdhënies dhe vendos kurse online për zhvillimin dhe përsosjen profesionale të kuadrit edukativ-arsimor. Mbledh të dhënat nga të gjitha shkollat fillore dhe të mesme të RMV për numrin e nxënësve dhe numrin e paraleleve sipas gjuhës në të cilën zhvillohet mësimi dhe

sipas saj përgatit rishikime dhe plane për shpërndarjen e dokumentacionit dhe evidencës pedagogjike për arsimin fillor dhe të mesëm.

Brenda sektorit janë institucionalizuar dy njësi:

- Njësia për veprimtarinë botuese dhe dokumentacionin pedagogjik;
- Njësia për zhvillimin e përmbajtjeve digjitale dhe kurseve online.

➢ **Sektori për monitorimin dhe vlerësimin e arritjeve të nxënësve dhe mësimdhënësve** bën hulumtime për përcjelljen dhe vlerësimin e arritjeve të nxënësve dhe mësimdhënësve, krijon mënyra dhe procedura moderne didaktike për monitorimin e arritjeve të nxënësve dhe mësimdhënësve, zbaton kontrolla të jashtëzakonshme të jashtme të arritjeve të nxënësve, bën përgatitjen dhe siguron përkrahjen e procesit të vetëevaluimit të shkollave, si dhe përkrahjen gjatë realizimit të maturës shtetërore. Në bashkëpunim me Qendrën Shtetërore të Provimeve (QSHP) siguron përkrahje dhe trajnim të mësimdhënësve në arsimin fillor dhe të mesëm për testimet ndërkombëtare PISA, TIMSS dhe PIRLS.

Në kuadër të këtij sektori, përveç njësisë me të njëjtin emër, janë edhe njësitë rajonale të Byrosë në Shtip, Strumicë, Veles, Kavadar, Kumanovë, Ohër, Prilep, Tetovë dhe Gostivar.

➢ **Sektori i logjistikës** me kompetencë kyçe për studimore-analitike dhe punë administrative-teknike, përkatësisht punë normative-juridike lidhur me veprimtarinë e Byrosë (rregullore, udhëzime, procedura dhe akte të ngjashme), përgatitjen e akteve ligjore dhe nënligjore dhe rregullore të tjera nga veprimtaria e arsimit, zbatimin e procedurave për ofrimin e shërbimeve në përgatitjen e programeve të reja mësimore, përkatësisht modernizimin e programeve ekzistuese në përputhje me ligjin, zbatimin e procedurave për akreditim të ofrimit të shërbimeve lidhur me zbatimin e programeve për trajnim të kuadrit edukativ-arsimor dhe kuadrit udhëheqës, si dhe zbatimin e procedurave për ofrimin e shërbimeve lidhur me hulumtimet fondamentale në arsim të përcaktuara në programin e punës dhe në ligjet për arsimin fillor dhe të mesëm.
Brenda sektorit janë institucionalizuar dy njësi:

- Njësia për çështje normative-juridike dhe punëve në zyrës;
- Njësia për furnizime publike dhe punë të përgjithshme.

➢ **Sektori për çështje financiare** me kompetencë kyçe për kryerjen e punëve që kanë të bëjnë me: përgatitjen e propozim buxhetit të Byrosë, QATP dhe QSHP (si përdorues të linjës së dytë të buxhetit të Byrosë), përgatitjen e planeve financiare vjetore dhe tremujore, ndjekjen dhe zbatimin e ligjeve, akteve nënligjore dhe rregulloreve të tjera që i referohen kontabilitetit dhe buxhetit si dhe përdorimit dhe të disponuarit e mjeteve të organeve shtetërore, përcjelljen e gjendjes dhe lëvizjen e mjeteve dhe burimin e mjeteve të Byrosë, përgatitjen e planit financiar të Byrosë, ndjekjen e realizimit të ardhurave dhe të shpenzimeve, përpilimin, marrjen, likuidimin dhe kontrollin e dokumenteve të kontabilitetit; llogariten dhe pagesën e pagave, mbajtjen e evidencës së pagave të nëpunësve shtetëror, punonjësve të tjerë dhe personave të emëruar në Byro, punë arkëtimi, hapjen e akreditivave dhe ndarjen e fondeve në njësitë rajonale dhe shuarja e tyre, mbajtjen e librave afariste të paraparë me Ligjin e Kontabilitetit, rakordimin e mjeteve dhe burimi i mjeteve në pasqyrën kontabël me pasqyrën e vërtetë, llogaritjen e amortizimit dhe revalorizimit, si dhe përgatitjen e llogarisë përfundimtare të Byrosë.

Brenda sektorit janë institucionalizuar tre njësi:

- Njësi për koordinim të buxhetit;
- Njësia e kontrollit të buxhetit; dhe
- Njësi e kontabilitetit dhe pagesave.

➢ **Njësia e menaxhimit me burime njerëzore** me kompetencë kyçe për kryerjen e punëve lidhur me strukturën organizative të Byrosë, përgatitjen e programit vjetor për aftësimin dhe përsosjen profesionale të nëpunësve administrativ dhe ndjekjen e progresit të tyre, mbajtjen e evidencës/dosjes personale, pushimet vjetore, pushimet me pagesë, pushimet mjekësore të punonjësve të Byrosë, të realizojë anketa dhe analiza për funksionimin efikas të problemeve në praktikën e njësive, gjetjen e dobësive në sistem, zbatimin e procedurave për punësim dhe ndërprerje të marrëdhënies së punës, të japë udhëzime lidhur me vlerësimin e nëpunësve administrativ dhe të dorëzojë formularët për vlerësimin e nëpunësve administrativ, të dorëzojë Raportin Vjetor për vlerësim të nëpunësve administrativ në Agjencinë për Administratë (AA).

- **Njësia e revizionit të brendshëm** me kompetencë kyçe për rritjen e efektivitetit të sistemeve të kontrollit të brendshëm dhe dhënien e rekomandimeve për eliminimin e parregullsive dhe dobësive të identifikuara, monitorimin e zbatimit të rekomandimeve të dhëna, hartimin e strategjive, planeve, informacioneve lidhur me revizionin e brendshëm, si dhe mbajtjen e dokumentacionit për kontrollet e kryera si dhe bashkëpunimin me revizorët nga Enti Shtetëror i Revizionit.

- **Njësia për planifikim strategjik, krijim të politikave dhe monitorim** koordinon përpilimin e Planit strategjik dhe monitoron zbatimin e vazhdueshëm të tij, bën vlerësimin e rezultateve të arritura dhe raportimin, punime studimore-analitike lidhur me definimin e prioriteteve strategjike të Byrosë së Zhvillimit të Arsimit, monitoron zbatimin e prioriteteve strategjike të Byrosë dhe Qeverisë, organizon, inicon bashkëpunim në procesin e përgatitjes së vendimit për përcaktimin e prioriteteve strategjike dhe jep propozime me masa, monitoron problemet sistemike dhe aktuale të paraqitura në zbatimin e prioriteteve strategjike, përpunim profesional të çështjeve të rëndësishme me rëndësi në zbatimin e dispozitive ligjore, përgatit teza për përpilimin e rregulloreve ligjore dhe të tjera, akteve të përgjithshme dhe punë informative-analitike, përgatitjen e analizave, raporteve dhe informacioneve në lidhje me planifikimin strategjik.


Byroja e Zhvillimit të Arsimit
Drejtori
Zëvendës dreitori
Sektori për zhvillimin e sistemit edukativ-arsimor dhe krijimin e standardeve, planeve dhe programeve mësimore
Njësia e zhvillimit të sistemit edukativ-arsimor dhe krijimit të standardeve, planeve dhe programeve mësimore në arsimin parashkollor dhe mësimin klasor
Njësia e zhvillimit të sistemit edukativ-arsimor dhe krijimit të standardeve, planeve dhe programeve mësimore në mësimin lëndor të arsimit fillor
Njësia e zhvillimit të sistemit edukativ-arsimor dhe krijimit të standardeve, planeve dhe programeve mësimore në arsimin gjimnaz, arsimin artistik dhe për lëndët e përgjithshme të arsimit profesional
Sektori për hulumtime në arsim
Njësia për hulumtim, zhvillim dhe çështje të sistemit
Njësia për projekte hulumtuese dhe bashkëpunim ndërkombëtar
Sektori për zhvillimin profesional të kuadrit edukativ-arsimor dhe punë profesionale-këshilluese
Njësia për zhvillim profesional të kuadrit edukativ-arsimor
Njësia për punë profesionale-këshilluese
Sektori për veprimtari botuese
Njësia për veprimtari botuese dhe dekumentacion pedagogjik
Njësia për krijim e përmbajtjeve digjitale dhe kurseve online
Sektori për monitorimin dhe vlerësimin e arritjeve të nxënësve dhe mësimdhënësve
Njësia për monitorimin dhe vlerësimin e arritjeve të nxënësve dhe mësimdhënësve
Njësitë rajonale në Tetovë, Ohër, Prilep, Veles, Kumanovë, Berovë dhe Kavadar
Sektori i logjistikës
Njësia për çështje normative-juridike dhe punëve të zyrës
Njësia për furnizime publike dhe punë të përgjithshme
Sektori për çështje financiare
Njësia për koordinim të buxhetit
Njësia e kontrollit të buxhetit
Njësia e kontabilitetit dhe pagesave
Njësia e menaxhimit me burime njerëzore
Njësia e revizionit të brendshëm
Njësia për planifikim strategjik, krijim të politikave dhe monitorim

## 1.8. MARRËDHËNIET ME ORGANET NË PËRBËRJE

Në kuadër të Byrosë së Zhvillimit të Arsimit ekzistojnë përdorues të linjës së dytë të buxhetit të Byrosë, dhe atë: Qendra Shtetërore e Provimeve dhe Qendra për Arsim dhe Trajnim Profesional.

## 1.9. PRIORITETET DHE QËLLIMET E ORGANIT TË ADMINISTRATËS SHTETËRORE

Prioriteti: **Avancimi dhe zhvillimi i procesit edukativ-arsimor në arsimin parashkollor, fillor dhe të mesëm**

**Qëllimet:**

- krijimi i standardeve kombëtare arsimore për arsimin parashkollor, fillor dhe të mesëm;
- hartimi i programeve të reja mësimore për arsimin fillor dhe të mesëm (gjimnaz, artistik dhe lëndët e përgjithshme në arsimin profesional);
- hulumtime dhe analiza për përparimin e aspekteve kyçe të procesit edukativ - arsimor;
- krijimi i koncepteve dhe akteve nënligjore sipas Ligjit për mësimdhënësit dhe bashkëpunëtorët profesional;
- ndryshime dhe plotësime në Ligjin e Byrosë së Zhvillimit të Arsimit;
- modernizimi i lëndëve të përgjithshme mësimore në arsimin e mesëm profesional sipas kërkesave të tregut të punës dhe ekonomisë.

Prioriteti: **Ngritja e zhvillimit të vazhdueshëm profesional dhe në karrierë të kuadrit edukativ-arsimor në arsimin parashkollor, fillor dhe të mesëm**

**Qëllimet:**

- fuqizimi i kompetencave të nevojshme të kuadrit edukativ-arsimor për realizimin cilësor të procesit edukativ-arsimor përmes ndjekjes së trajnimeve të akredituara dhe sigurimin e zhvillimit në karrierë;
- krijimi i procedurave dhe instrumenteve për përcjelljen dhe përparimin e punës së kuadrit edukativ-arsimor si dhe monitorimi i procesit edukativ-arsimor;
- ofrimi i ndihmës së vazhdueshme profesionale-këshilluese në shkolla për ndryshimet konceptuare dhe sistemore në procesin edukativ-arsimor.

Prioriteti: **Avancimi i procesit të monitorimit dhe vlerësimit të vazhdueshëm të nxënësve**

**Qëllimet:**

- reformimi i procesit të monitorimit dhe vlerësimit;
- ngritja i aftësive të mësimdhënësve për vlerësim objektiv;
- harmonizimi i dokumentacionit dhe evidencës pedagogjike në përputhje me kërkesat dhe nevojat e arsimit parashkollor, fillor dhe të mesëm.

Prioriteti: **Zgjidhja e marrëdhënieve pronësore – juridike të Byrosë së Zhvillimit të Arsimit**

**Qëllimi:**

- disponueshmëria me hapësira të veta për punë në Shkup dhe në njësitë rajonale.

## 1.10. RISHIKIM I REZULTATEVE TË ARRITURA NGA VITI 2021

Në përputhje me kompetencat që ka dhe në drejtim të përmbushjes së prioriteteve dhe qëllimeve të saj, Byroja e Zhvillimit të Arsimit ka krijuar aktivitete që realizohen në bazë të rregullt, gjë që siguron vazhdimësi lidhur me aktivitetet e ardhshme.

Rishikimi i rezultateve të arritura nga viti 2021 përfshin edhe komponentët kyç të funksioneve, përshkrimin e tyre si dhe informacionet që tregojnë rezultatet e arritura.

Qëllimet/rezultatet dhe aktivitetet e projektuara janë të grupuara nën çdo prioritet strategjik dhe janë të ndërlidhura horizontalisht/vertikalisht përmes të gjitha qëllimeve strategjike me ndikime të forta në drejtim të prioriteteve.

Byroja e Zhvillimit të Arsimit në vitin 2021 ka punuar intenzivisht në të gjitha segmentet në kompetencë të saj.

Më poshtë janë renditur disa nga rezultatet dhe aktivitetet kryesore të projektuara:

- hartimi i dokumenteve programore (plane mësimore dhe programe mësimore për arsimin fillor bazuar në standardet e reja me rezultatet e të nxënit);

- hartimi i planit mësimor dhe programeve mësimore në përputhje me kërkesat e Qeverisë, MASH-it dhe dinamikës së zbatimit të reformave në arsimin fillor;
- të përpiluara: Doracak për realizimin e mësimit të arsimit teknik dhe informatikës në kl. IV (të katërt); Doracak me materiale për mësim për arsim muzikor në kl. I (të parë); Doracak për mësimdhënësit për realizimin e programit mësimor nga lënda e arsimit muzikor në kl. IV (të katërt); Materiale për mësim në kl. I (të parë) dhe kl. IV (të katërt); Test për kualifikim provim pranues për arsimin e mesëm; Test i matematikës për provim pranues të lëndës së matematikës në gjimnazin matematikë – informatikë;
- janë përpiluar: Udhëzues për zbatimin e Rregullores për monitorimin dhe vlerësimin e punës së mësimdhënësve; Udhëzues për planifikim, përgatitje, caktimin dhe vlerësimin e detyrave të shtëpisë në kl. I (të parë) dhe kl. IV (e katërtë); matrica për përpilimin e programeve të reja mësimore të arsimit fillor; koncept për lëndën mësimore Shoqëri/histori; koncept për lëndën mësimore shkencat natyrore; Udhëzues për lëndët e lira zgjedhore të arsimit fillor në përputhje me Konceptin e ri; standarde për arsim ndërkulturor; instrument për vizita këshillëdhënëse – profesionale në kl. I (të parë) dhe kl. IV (të katërt) të arsimit fillor;
- është hartuar Koncepti për arsimin fillor;
- janë realizuar trajnime për kuadrin edukativ-arsimor për zbatimin e materialeve didaktike si dhe për tema të tjera lidhur me procesin edukativ-arsimor ku janë trajnuar **1203** edukatorë;
- janë realizuar trajnime të kuadrit edukativ-arsimor (të trajnuar **60** trajnues-këshilltarë të Byrosë, profesorë universitarë, mësimdhënës të shkollave fillore) për: **Moduli 1** – trajnim për Konceptin për arsimin fillor (janë realizuar **165** trajnime dhe janë trajnuar **3069** mësimdhënës klasor); **Moduli 2** – trajnim për planifikim dhe realizim të programeve të reja mësimore (janë realizuar **175** trajnime dhe janë trajnuar **3161** mësimdhënës klasor); dhe **Moduli 3** – trajnim për planifikim dhe realizim të programeve të reja mësimore (trajnim online); **12** mësimdhënës të trajnuar nga **11** shkolla fillore në vend për realizimin e mësimit nga lënda Inovacionet në kl. IX (e nëntë) në arsimit fillor;
- janë realizuar vizita profesionale – këshilluese të **653** mësimdhënësve të cilët realizojnë mësim në kl. I (të parë) dhe kl. IV (të katërt) në **174** shkolla fillore;
- janë realizuar hulumtime: 1. „Përmirësimi i cilësisë së teksteve shkollore“ (krijimi i standardeve për tekstet digjitale, mjete të tjera elektronike mësimore/materiale elektronike mësimore), 2. „Mësimdhënësit si faktorë të arsimit ndërkulturor“ (sipas detyrës lidhur me Konceptin për aktivitete jashtëmësimore;
- është hartuar Programi për përpilimin e teksteve shkollore për vitin 2021;
- Projekti: „Arsimi gjithpërfshirës seksual“ (programi AGJS pilotohet në katër shkolla pilot. Për të matur efektet nga evaluimi, është realizuar evaluim me paratest dhe posttest);
- Projekti: „Parandalimi dhe lufta kundër trafikimit me njerëz në Maqedoninë e Veriut“ (këshilltarët e trajnuar gjatë kësaj periudhe kanë realizuar trajnime në distancë me

përfaqësues nga ekipet për zhvillim profesional në shkollat fillore dhe të mesme me temë: „Prevenimi dhe lufta kundër trafikimit me fëmijë“ (janë trajnuar gjithsej **1850** mësimdhënës të shkollave fillore dhe të mesme);
- Projekt: „Arsimi i fëmijëve jashtë sistemit arsimor“ (është realizuar hulumtimi „Praktikat e identifikimit, regjistrimit dhe punës me fëmijët që janë jashtë procesit arsimor“);
- është zbatuar procedura për akreditim të ofrimit të shërbimeve lidhur me realizimin e programeve për trajnim dhe ofruesit e shërbimeve. Është realizuar monitorimi dhe vlerësimi i programeve të akredituara;
- janë realizuar **307** trajnime me mësimdhënësit e shkollave të mesme (janë trajnuar **6572** mësimdhënës);
- janë realizuar aktivitete për vlerësimin e kandidatëve për mësimdhënës-mentor të dorëzuara nga MASH, dhe pas shpalljes së konkursit edhe evaluim nga ana e komisioneve të formuara;
- është hartuar Propozim koncepti për vetëevaluim të shkollave fillore dhe të mesme;
- është dhënë përkrahje në testimin ndërkombëtar provë PISA 2021 (janë trajnuar të gjithë mësimdhënësit që ligjërojnë në vitin e parë të arsimit të mesëm në lëndët mësimore: gjuhë maqedone dhe letërsi, gjuhë shqipe dhe letërsi, matematikë, fizikë, kimi dhe biologji); TIMSS 2021, PIRLS 2021 (janë realizuar **90** takime online me mësimdhënësit e klasave të katërta, në gjuhën mësimore maqedone dhe **36** në gjuhën mësimore shqipe;
- janë përpiluar udhëzues për vlerësim me udhëzime konkrete sipas periudhave të mësimit në sistemin tonë arsimor;
- është botuar dhe lëshuar dokumentacioni pedagogjik për shkollat fillore dhe të mesme në gjuhën maqedone, shqipe, turke, serbe dhe gjuhën boshnjake.

Një pjesë të aktiviteteve të realizuara gjatë periudhës 2021, Byroja e Zhvillimit të Arsimit i realizoi përmes ndihmës dhe mbështetjes profesionale të organizatave joqeveritare, derisa një pjesë tjetër edhe me angazhimin e ekspertëve të jashtëm, organizimin e trajnimeve të mësimdhënësve dhe përgatitjen e dokumenteve dhe materialeve për përmirësimin e cilësisë së arsimit si dhe për përkrahjen e mësimdhënësve.

- Bashkëpunimi me UNICEF: Mbështetja në implementimin e reformave në arsimin fillor (përpilimin e materialeve për mësim të klasave të para dhe të katërta dhe realizimin e trajnimeve për mësimdhënësit e klasave të njëjta), aktivitete lidhur me web portalin EDUINO dhe Platformës kombëtare për e-mësim nga distanca;
- Bashkëpunimi me zyrën e Këshillit të Evropës në Shkup;
- Bashkëpunimi me Këshillin britanik;
- Fondacioni i Fëmijëve Pestaloci.

## 1.11. RISHIKIM I REZULTATEVE TË ARRITURA NGA VITI 2022

Përmes aktiviteteve të paraqitura në Raportin për realizimin e planit vjetor të Byrosë për vitin 2022, shihet se plani vjetor në masë të madhe është realizuar. Aktivitetet dhe detyrat e punës së të punësuarve, në masë të madhe janë kryer me cilësinë e duhur dhe janë arritur qëllimet e përcaktuara, gjithashtu janë realizuar edhe aktivitete dhe detyra që nuk ishin të parapara në planin e punës në vitin aktual.
Në bazë të kompetencave që ka dhe në drejtim të përmbushjes së prioriteteve dhe qëllimeve, Byroja e Zhvillimit të Arsimit, në vitin 2022 i arriti këto rezultate të dëshiruara dhe të planifikuara:

- është realizuar trajnim për mbështetje të procesit për krijimin e Komuniteteve profesionale për mësim në nënsistemin e arsimit dhe edukimit parashkollor (janë trajnuar **200** edukatorë nga të gjitha kopshtet publike të fëmijëve në vend);
-janë krijuar **400** lojëra/aktivitete dhe **1600** video leksione për fëmijët e moshës nga 3 deri në 6 vjet dhe janë vendosur në platformën EDUINO;
- është përpiluar Doracak për realizimin e aktiviteteve praktike për integrimin e mjedisit jetësor dhe ndryshimeve klimatike në programin e mësimit dhe zhvillimit të hershëm të fëmijëve në arsimin parashkollor përmes të mësuarit me përvojë;
- janë hartuar programe të reja mësimore të bazuara në standardet e reja me rezultatet e të nxënit për kl. III (e tretë);
- është miratuar plani i ri mësimor për vitin 2022/2023 sipas konceptit të ri;
- janë realizuar trajnime të kuadrit edukativ-arsimor për realizimin e standardeve dhe programeve të reja mësimore;
- janë trajnuar **91** grupe (anëtarë të Ekipeve inkluzive të shkollës) të shkollave fillore në vend për Hartimin e PAI dhe programit mësimor të modifikuar, me qëllim përmirësimin e cilësisë së arsimit gjithëpërfshirës në shkollat fillore;
- janë trajnuar **9** mësimdhënës të shkollave fillore për realizimin e mësimit nga lënda Inovacionet në kl. IX (e nëntë) të arsimit fillor;
- është realizuar trajnim me temë „Pilotimi i moduleve për shëndetin mendor“ me të cilën janë trajnuar **5** këshilltarë nga Byroja dhe **37** bashkëpunëtorë profesional (mentorë nga fusha e shëndetit mendor) të shkollave fillore dhe të mesme në vend; Këshilltarët e trajnuar ofrojnë mbështetje të 37 bashkëpunëtorëve profesional mentorë nga shkollat fillore dhe të mesme; 37 bashkëpunëtorë profesional të trajnuar nga shkollat fillore dhe të mesme ofrojnë mbështetje bashkëpunëtorëve tjerë profesional nga shkollat fillore dhe të mesme në vend për realizimin e aktiviteteve për promovimin e shëndetit mendor;
- është përgatitur modul për trajnim online me temë „Promovimi i shëndetit mendor tek nxënësit“ në bashkëpunim me zyrën e UNICEF në Shkup, e cila është vendosur në platformën EDUINO;

- janë hartuar programe të reja mësimore nga lëndët mësimore (të detyrueshme dhe zgjedhore) për vitin III (e tretë) të gjimnazit matematikë-informatikë;
- është realizuar trajnim i **12** mësimdhënësve të cilët realizojnë mësim nga gjuha frënge në paralelet dygjuhëshe frankofone në vitin e I, II, II dhe IV të gjimnazit dhe arsimit të mesëm profesional për planifikim dhe realizim të mësimit sipas programeve të reja mësimore;
- janë dhënë mendime profesionale për të gjitha tekstet shkollore, revistat dhe fletoret e punës për të cilët është dorëzuar kërkesë nga ana e Shërbimit Pedagogjik, si dhe për të gjitha projektet e dorëzuara që realizohen nga organizatat joqeveritare dhe institucionet e tjera;
- janë realizuar tre hulumtime dhe atë:
1. *Efektet e implementimit të konceptit të ri për arsimin fillor në kl. I (të parë) dhe IV (të katërt);*
2. *Ndryshimi i qëndrimeve të mësimdhënësve ndaj zbatimit të AGJS 2020-2022;*
3. Është realizuar faza e parë nga hulumtimi *Matja e cilësisë së mësimit dhe zhvillimit të hershëm të fëmijëve të kopshteve publike për fëmijë* duke përdorur instrumentin MELQO. (Janë përfshirë 1019 fëmijë, 1019 edukatorë dhe 917 prindër të fëmijëve të përfshirë në hulumtim, 103 grupe edukative dhe 103 edukatorë dhe 103 drejtorë të kopshteve publike për fëmijë);
- Projekt: <u>Shkrim-leximi mediatik</u> (është përgatitur koncepti për Shkrim-lexim mediatik në arsimin fillor; në programet mësimore për gjuhë amtare nga klasa e parë deri në të pestë është futur tema për Shkrim-lexim mediatik dhe kultura mediatike; është përgatitur Doracak për shkrim-lexim mediatik për mësimdhënësit e kl.V (së pestë);
- janë realizuar trajnime të mësimdhënësve nga mësimi klasor për futjen e suksesshme të temës së re shkrim-leximi mediatik në kuadër të lëndës mësimore nga gjuha amtare (maqedone, shqipe, turke, serbe dhe boshnjake);
- janë përgatitur materiale për mësim të përmbajtjeve nga kuartali i parë për lëndët mësimore sipas planit mësimor dhe programet adekuate mësimore për klasën e parë, të dytë, të katërt, dhe të pestë të cilët u përdorën në mësim;
- është krijuar, botuar dhe lëshuar dokumentacioni dhe evidenca pedagogjike në shkollat fillore dhe të mesme;
- është dhënë mbështetje në testimin ndërkombëtar provë PISA 2022 (janë realizuar 90 trajnime online të mësimdhënësve, janë trajnuar 659 mësimdhënës, janë realizuar 1515 vizita online në orë mësimore); mbështetje në testimin shtetëror, maturën shtetërore, dhe përgatitje për TIMSS testimin 2023;
- është krijuar kursi online "Të menduarit kritik, zgjidhja e problemeve dhe Micro:bit" dhe është vendosur në LMS sistemin e web faqes së Byrosë;
- është hartuar dhe publikuar Programi për zhvillim profesional të mësimdhënësve për vitin 2022 dhe Programi për zhvillim profesional të bashkëpunëtorëve profesional për vitin 2022;

- janë akredituar **18** programe për trajnim të mësimdhënësve dhe **4** programe për trajnim të bashkëpunëtorëve profesional të shkollave fillore;
- është përpiluar dhe publikuar Katalogu i programeve të akredituara për trajnim të mësimdhënësve në shkolla fillore dhe Katalogu i programeve të akredituara për trajnim të bashkëpunëtorëve profesional në shkolla fillore;
- janë realizuar trajnime të akredituara mësimdhënësve dhe bashkëpunëtorëve profesional (janë trajnuar gjithsej **14 884** nga të cilët 14 083 mësimdhënës dhe 801 bashkëpunëtorë profesional); trajnimet janë monitoruar nga ekipet profesionale të Byrosë në aspektin e cilësisë dhe kryerjen e shërbimeve sipas afateve të caktuara;
- është bërë monitorimi dhe vlerësimi i punës së mësimdhënësve kandidatë për avancim në titull.

Një pjesë të aktiviteteve të realizuara gjatë vitit 2022, Byroja e Zhvillimit të Arsimit i realizoi me ndihmën dhe mbështetjen profesionale të organizatave joqeveritare, ndërsa një pjesë tjetër edhe me angazhimin e ekspertëve të jashtëm, organizimin e trajnimeve të mësimdhënësve dhe përgatitjen e dokumenteve dhe materialeve për përmirësimin e cilësisë së arsimit si dhe mbështetjen e mësimdhënësve.

- Bashkëpunimi me UNICEF;
- Bashkëpunimi me zyrën e Këshillit të Evropës në Shkup;
- Bashkëpunimi me Këshillin Britanik;
- Bashkëpunimi me organizatën ndërkombëtare IREKS.

## 2. PROGRAME

Programi 1: **Arsimi cilësor parashkollor, fillor dhe i mesëm**

**2.1.** Plani i veprimit të Programit: **Arsim cilësor parashkollor, fillor dhe i mesëm**

| **A: Arsyeja dhe dizajni i Programit 1** |
|---|
| **Arsyetimi:** Programi **Arsim cilësor parashkollor, fillor dhe i mesëm** rezulton nga:<br>1. Prioriteti strategjik i Qeverisë së RMV që përmban Vendimi për prioritete strategjike për vitin 2023 „rritja e cilësisë së arsimit me qasje për të gjithë, sipas kërkesës së tregut të punës, zhvillimi dhe promovimi i kulturës dhe sportit“.<br>Njëkohësisht programi rrjedh nga qëllimet parësore në përmbajtje të Vendimit për prioritete strategjike për vitin 2023 „zhvillimi i arsimit cilësor me qasje për të gjithë, që do të krijojë kuadër të aftë për të përmbushur nevojat e tregut të punës, të edukuar për të respektuar të drejtat civile, tolerancë reciproke dhe zhvillim të multikulturalizmit dhe ndërkulturalizmit “. |

| |
|---|
| Gjithashtu, programi bazohet në Konceptin e miratuar për arsimin fillor (2021), si dhe në të gjitha aktet nënligjore dhe profesionale lidhur me Konceptin. |
| 2. NPAA Kapitulli 3.Aftësia për të ndërmarrë detyrime të ACQUIS,<br>3.26. Arsimi, kultura dhe rinia |
| Prioritetet strategjike të Byrosë së Zhvillimit të Arsimit:<br>- avancimi dhe zhvillimi i procesit edukativ–arsimor në arsimin parashkollor, fillor dhe të mesëm;<br>- ngritja e zhvillimit të vazhdueshëm profesional dhe në karrierë të kuadrit edukativ-arsimor në arsimin parashkollor, fillor dhe të mesëm;<br>- avancimi e procesit të monitorimit dhe vlerësimit të vazhdueshëm të arritjeve të nxënësve.<br><br>Qëllimet parësore të Byrosë së Zhvillimit të Arsimit:<br>- të implementohen reformat në arsimin fillor sipas Konceptit për arsim fillor;<br>- të krijohen standarde arsimore kombëtare dhe programe mësimore si dhe plane mësimore të arsimit të mesëm;<br>- të realizohen hulumtime për avancimin e arsimit;<br>- të implementohet Koncepti për arsimin gjithpërfshirës;<br>- të përmirësohen kompetencat e kuadrit edukativ-arsimor;<br>- të sigurohet monitorimi i mësimdhënësve përmes vizitave profesionale dhe sigurimin e zhvillimit të tyre në karrierë. |
| Qëllimi i Programit: **përmirësimi i cilësisë së njohurive të fëmijëve dhe nxënësve** |
| **Indikatorët e suksesit të Programit:**<br>- krijimi i standardeve të reja për arsimin parashkollor, fillor dhe të mesëm;<br>- hartimi i programeve të reja mësimore, koncepteve dhe akteve nënligjore;<br>- numri i hulumtimeve dhe analizave në fushën e arsimit;<br>- numri i kuadrit edukativ-arsimor të trajnuar me kompetenca të përforcuara;<br>- botimi dhe shpërndarja e dokumentacionit dhe evidencës pedagogjike. |
| Programi është: (shënoni llojin e Programit)<br>√ Horizontal √ Vertikal |

| **Nënprogramet (komponentat) e Programit: Arsim cilësor parashkollor, fillor dhe i mesëm** | |
|---|---|
| **Nënprogrami 1:**<br>Standardet e arsimit parashkollor | **Indikatorët e suksesit:**<br>- standardet e krijuara për arsimin parashkollor;<br>- numri i kuadrit edukativ-arsimor të trajnuar për zbatimin e standardeve dhe normativit si dhe për tema të tjera lidhur me procesin edukativ-arsimor në vitin 2023, 2024 dhe 2025. |
| **Nënprogrami 2:**<br>Standardet, planet dhe programet mësimore të arsimit fillor | **Indikatorët e suksesit:**<br>- numri i programeve mësimore të hartuara bazuar në standardet e reja me rezultatet e të nxënit në vitin 2023, 2024 dhe 2025;<br>- numri i kuadrit edukativ-arsimor të trajnuar për zbatimin e standardeve dhe programeve të reja mësimore në vitin 2023, 2024 dhe 2025;<br>- numri i kuadrit edukativ-arsimor të trajnuar për arsimin gjithëpërfshirës dhe për tema të tjera lidhur me procesin edukativ-arsimor në vitin 2023, 2024 dhe 2025. |
| **Nënprogrami 3:**<br>Standardet, planet dhe programet mësimore të arsimit të mesëm (gjimnaz, artistik, gjimnazi i sportit, akademia e sportit, arsimi i mesëm profesional, arsimi i nxënësve me nevoja të veçanta arsimore dhe gjimnazi matematikë-informatikë) | **Indikatorët e suksesit:**<br>- standardet e krijuara për arsimin e mesëm bazuar në kompetenca kyçe në kontekstin e të mësuarit gjatë gjithë jetës dhe nevojat e tregut të punës dhe ekonomisë;<br>- numri i programeve mësimore të hartuara në bazë të standardeve të reja me rezultatet e të nxënit në vitin 2023, 2024 dhe 2025;<br>- numri i kuadrit edukativ-arsimor të trajnuar për zbatimin e standardeve |

| | |
|---|---|
| | dhe programeve të reja mësimore në vitin 2023, 2024 dhe 2025;<br>- numri i kuadrit edukativ-arsimor të trajnuar për arsimin gjithëpërfshirës dhe për tema të tjera lidhur me procesin edukativ-arsimor në vitin 2023, 2024 dhe 2025;<br>- numri i programeve të reja për provim për lëndët e përgjithshme të maturës shtetërore dhe shkollore të nxënësve nga arsimi i mesëm profesional katërvjeçar i reformuar, bazuar rezultateve të nxënit. |
| **Nënprogrami 4:**<br>Hulumtime për avancimin e arsimit parashkollor, fillor dhe të mesëm | **Indikatorët e suksesit:**<br>- numri i analizave në vitin 2023, 2024 dhe 2025;<br>- numri i hulumtimeve në vitin 2023, 2024 dhe 2025. |
| **Nënprogrami 5:**<br>Zhvillimi i vazhdueshëm profesional i kuadrit edukativ-arsimor të arsimit parashkollor, fillor dhe të mesëm | **Indikatorët e suksesit:**<br>- numri i vizitave për monitorim dhe vlerësim të punës së mësimdhënësve dhe bashkëpunëtorëve profesional në vitin 2023, 2024 dhe 2025;<br>- numri i mësimdhënësve dhe bashkëpunëtorëve profesional të trajnuar përmes programeve të akredituara për trajnim dhe ofruesit e shërbimit në vitin 2023, 2024 dhe 2025;<br>- Katalogu i programeve të akredituara për trajnim të mësimdhënësve dhe bashkëpunëtorëve profesional të shkollave fillore – i shtypur/publikuar në ueb faqen e Byrosë. |
| **Nënprogrami 6:**<br>Monitorimi dhe evaluimi i arritjeve të nxënësve dhe mësimdhënësve | **Indikatorët e suksesit:**<br>- instrumentet e përpiluara për vetëevalumin e shkollave; |

| | |
|---|---|
| | - numri i drejtorëve dhe shërbimit profesional të trajnuar për procesin e vetëevaluimit të shkollave në vitin 2023, 2024 dhe 2025;<br>- numri i vizitave për mbështetje të procesit të vetëevaluimit të shkollave;<br>- numri i mësimdhënësve të trajnuar për vlerësim objektiv të nxënësve në vitin 2023, 2024 dhe 2025.. |
| **Nënprogrami 7:**<br>Dokumentacioni dhe evidenca pedagogjike, përmbajtjet digjitale dhe kurset online | **Indikatorët e suksesit:**<br>- dokumentacioni dhe evidenca pedagogjike e botuar dhe e distribuuar për arsimin fillor dhe të mesëm në vitin 2023, 2024 dhe 2025;<br>- kurse online për kuadrin edukativ-arsimor të arsimit fillor dhe të mesëm;<br>- literaturë profesionale e botuar. |

## B: Plan veprimi i programit:
## Arsimi cilësor parashkollor, fillor dhe i mesëm

**Nënprogrami 1:** Standardet e arsimit parashkollor

| Aktiviteti | Përgjegjës | Konsultuar | Korniza kohore | | Burimet e nevojshme | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | Fillimi (muaji/viti) | Mbarimi (muaji/viti) | Njerëzore | | | Financiare (MKD) | | |
| | | | | | Viti I | Viti II | Viti III | Viti I | Viti II | Viti III |
| 1. Krijimi i standardeve për mësim dhe zhvillim të hershëm të fëmijëve nga mosha 0 deri në 6 vjeç | - Sektori për zhvillimin e sitemit edukativ-arsimor dhe krijimit të standardeve, planeve dhe programeve mësimore<br>- Njësia për zhvillimin e sistemit edukativ-arsimor dhe krijimit të standardeve, planeve dhe programeve mësimore në arsimin parashkollor dhe mësimin klasor | - MPPS,<br>- MASH,<br>- UKM,<br>- Fakulteti pedagogjik,<br>- UNICEF<br>- zyra e BE në RMV<br>- përfaqësues të kopshteve të fëmijëve | Kuartali I 2023 | Kuartali IV 2023 | 30 | | | 300.000 | | |

| | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 2. Realizimi i trajnimeve të kuadrit edukativ-arsimor për zbatimin e standardeve dhe normativave të reviduara si dhe për tema tjera lidhur me procesin edukativ-arsimor | - Sektori për zhvillimin e sistemit edukativ-arsimor dhe krijimit të standardeve, planeve dhe programeve mësimore<br>- Njësia për zhvillimin e sistemit edukativ-arsimor dhe krijimit të standardeve, planeve dhe programeve mësimore në arsimin parashkollor dhe mësimin klasor | - MPPS,<br>-MASH,<br>-UKM,<br>- Fakulteti pedagogjik,<br>- UNICEF,<br>- zyrat e BE në RMV,<br>- përfaqësues të kopshteve të fëmijëve. | Kuartali IV 2023 | Kuartali IV 2024 | | 5 | | | | |
| **Gjithsej aktivitete në vitin e I: 2** | | | | | | | | 300.000 | | |
| **Gjithsej aktivitete në vitin e II: 1** | | | | | | | | | | |
| **Gjithsej aktivitete në vitin e III: 0** | | | | | | | | | | |
| **Gjithsej aktivitete të nënprogramit 1: 3** | | | | | | | | 300.000 | | |

**Nënprogrami 2:** Standardet, planet dhe programet mësimore të arsimit fillor

| Aktiviteti | Përgjegjës | Konsultuar | Korniza kohore | | Burimet e nevojshme | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | Fillimi (muaji/viti) | Mbarimi (muaji/viti) | Njerëzore | | | Financiare (MKD) | | |
| | | | | | Viti I | Viti II | Viti III | Viti I | Viti II | Viti III |
| 1. Hartimi i programeve të reja mësimore bazuar në standardet e reja me rezultatet e të nxënit | - Sektori për zhvillimin e sistemit edukativ-arsimor dhe krijimit të standardeve, planeve dhe programeve mësimore | - sektorë tjerë të Byrosë, -bashkëpunëtorë të jashtëm. | Kuartali I 2023 | Kuartali III 2025 | 100 | 100 | 100 | 700.000 | 3.500.000 | 3.500.000 |
| 2. Realizimi i trajnimeve të kuadrit edukativ-arsimor për zbatimin e standardeve dhe programeve të reja mësimore si dhe për tema tjera lidhur me procesin edukativ-arsimor | - Sektori për zhvillimin e sistemit edukativ-arsimor dhe krijimit të standardeve, planeve dhe programeve mësimore | - sektorë tjerë të Byrosë, -bashkëpunëtorë të jashtëm. | Kuartali I 2023 | Kuartali III 2025 | 40 | 40 | 40 | 100.000 | 300.000 | 300.000 |
| **Gjithsej aktivitete në vitin e I: 2** | | | | | | | | 800.000 | | |
| **Gjithsej aktivitete në vitin e II: 2** | | | | | | | | | 3.800.000 | |
| **Gjithsej aktivitete në vitin e III: 2** | | | | | | | | | | 3.800.000 |
| **Gjithsej aktivitete të nënprogramit 2: 6** | | | | | | | | 800.000 | 3.800.000 | 3.800.000 |

**Nënprogrami 3:** Standardet, planet dhe programet mësimore të arsimit të mesëm (gjimnaz, artistik, gjimnazi i sportit, akademia e sportit, arsimi i mesëm profesional, arsimi i nxënësve me nevoja të veçanta arsimore dhe gjimnazi matematikë-informatikë)

| Aktiviteti | Përgjegjës | Konsultuar | Korniza kohore | | Burimet e nevojshme | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | Fillimi (muaji/viti) | Mbarimi (muaji/viti) | Njerëzore | | | Financiare (MKD) | | |
| | | | | | Viti I | Viti II | Viti III | Viti I | Viti II | Viti III |
| 1. Krijimi i standardeve për arsimin e mesëm | - Sektori për zhvillimin e sistemit edukativ-arsimor dhe krijimit të standardeve, planeve dhe programeve mësimore | - Sektorë tjerë të Byrosë, -bashkëpunëtorë të jashtëm. | Kuartali I 2023 | Kuartali I 2024 | 20 | 20 | | 200.000 | | |
| 2. Hartimi i programeve të reja mësimore bazuar në standardet e reja për arsimin e mesëm | - Sektori për zhvillimin e sistemit edukativ-arsimor dhe krijimit të standardeve, planeve dhe programeve mësimore | - Sektorë tjerë të Byrosë, -bashkëpunëtorë të jashtëm. | Kuartali IV 2023 | Kuartali IV 2025 | 150 | 150 | 150 | 500.000 | 3.500.000 | 3.500.000 |
| 3. Realizimi i trajnimeve të kuadrit edukativ-arsimor | - Sektori për zhvillimin e | - Sektorë tjerë të Byrosë, | Kuartali III 2024 | Kuartali III 2025 | | 60 | 60 | | 500.000 | 500.000 |

| | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| për zbatimin e standardeve dhe programeve të reja mësimore si dhe për tema tjera lidhur me procesin edukativ-arsimor | sistemit edukativ-arsimor dhe krijimit të standardeve, planeve dhe programeve mësimore | -bashkëpunëtorë të jashtëm. | | | | | | | | |
| 4.Përpilimi i programeve të reja për provim nga lëndët e përgjithshme për maturën shtetërore dhe shkollore për nxënësit e arsimit të mesëm profesional katërvjeçar të reformuar, bazuar në rezultatet e të nxënit | - Sektori për zhvillimin e sistemit edukativ-arsimor dhe krijimit të standardeve, planeve dhe programeve mësimore | - Sektorë tjerë të Byrosë,<br>-bashkëpunëtorë të jashtëm. | Kuartali II 2023 | Kuartali III 2023 | 150 | | | | | |
| **Gjithsej aktivitete në vitin e I: 3** | | | | | | | | 700.000 | | |
| **Gjithsej aktivitete në vitin e II: 3** | | | | | | | | | 4.000.000 | |
| **Gjithsej aktivitete në vitin e III: 2** | | | | | | | | | | 4.000.000 |
| **Gjithsej aktivitete të nënprogramit 3: 8** | | | | | | | | 700.000 | 4.000.000 | 4.000.000 |

| **Nënprogrami 4:** Hulumtime për përmirësimin e arsimit parashkollor, fillor dhe të mesëm | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **Aktiviteti** | **Përgjegjës** | **Konsultuar** | **Korniza kohore** | | **Burimet e nevojshme** | | | | | | |
| | | | **Fillimi (muaji/viti)** | **Mbarimi (muaji/viti)** | **Njerëzore** | | | **Financiare (MKD)** | | | |
| | | | | | Viti I | Viti II | Viti III | Viti I | Viti II | Viti III |
| 1. Analiza e teksteve shkollore, literaturës profesionale dhe revistave të fëmijëve si dhe përpilimi i materialeve për mësim/teksteve shkollore për periudhën e parë të arsimit fillor | - Sektori i hulumtimit në arsim | - Sektorë tjerë të Byrosë,<br>- SHP,<br>- MASH,<br>- MPPS. | Në kontinuitet | Në kontinuitet | 5 | 5 | 5 | | | |
| 2. Analiza e projekteve shkencore-studimore në fushën e arsimit | - Sektori i hulumtimit në arsim | - Sektorë tjerë të Byrosë,<br>- MASH. | Në kontinuitet | Në kontinuitet | 3 | 3 | 3 | | | |
| 3. Hulumtime për avancimin e aspekteve kyçe të arsimit fillor | - Sektori i hulumtimit në arsim | - Sektorë tjerë të Byrosë,<br>- bashkëpunëtorë të jashtëm. | Në kontinuitet | Në kontinuitet | 20 | 20 | 20 | 100.000 | 500.000 | 500.000 |
| 4. Hulumtime për avancimin dhe reformimin e arsimit të mesëm | - Sektori i hulumtimit në arsim | - Sektorë tjerë të Byrosë,<br>- bashkëpunëtorë të jashtëm. | Në kontinuitet | Në kontinuitet | 20 | 20 | 20 | 100.000 | 500.000 | 500.000 |
| 5. Hulumtime për përmirësimin dhe përforcimin e arsimit parashkollor | - Sektori i hulumtimit në arsim | - Sektorë tjerë të Byrosë,<br>- bashkëpunëtorë të jashtëm. | Në kontinuitet | Në kontinuitet | | 10 | 10 | | 200.000 | 200.000 |

| | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 6.Realizimi i projekteve shkencore-studimore | - Sektori i hulumtimit në arsim | - Organizata joqeveritare<br>- bashkëpunëtorë të jashtëm. | Në kontinuitet | Në kontinuitet | 20 | 20 | 20 | 100.000 | 500.000 | 500.000 |
| **Gjithsej aktivitete në vitin e I: 6** | | | | | | | | 300.000 | | |
| **Gjithsej aktivitete në vitin e II: 6** | | | | | | | | | 1.700.000 | |
| **Gjithsej aktivitete në vitin e III: 6** | | | | | | | | | | 1.700.000 |
| **Gjithsej aktivitete të nënprogramit 4: 18** | | | | | | | | 300.000 | 1.700.000 | 1.700.000 |

**Nënprogrami 5:** Zhvillimi i vazhdueshëm profesional i kuadrit edukativ-arsimor të arsimit parashkollor, fillor dhe të mesëm

| Aktiviteti | Përgjegjës | Konsultuar | Korniza kohore | | Burimet e nevojshme | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | Fillimi (muaji/viti) | Mbarimi (muaji/viti) | Njerëzore | | | Financiare (MKD) | | |
| | | | | | Viti I | Viti II | Viti III | Viti I | Viti II | Viti III |
| 1. Përpilimi i Planit për monitorim dhe vlerësim të punës së mësimdhënësve dhe bashkëpunëtorëve profesional | - Njësia për punë profesionale-këshilluese | - Sektorë tjerë të Byrosë | Kuartali I 2023<br>Kuartali I 2024<br>Kuartali I 2025 | Kuartali I 2023<br>Kuartali I 2024<br>Kuartali I 2025 | 6 | 6 | 6 | | | |
| 2. Realizimi i vizitave për monitorim dhe vlerësim të punës së mësimdhënësve dhe bashkëpunëtorëve profesional | - Njësia për punë profesionale-këshilluese | - Sektorë tjerë të Byrosë | Kuartali I 2023<br>Kuartali I 2024<br>Kuartali I 2025 | Kuartali IV 2023<br>Kuartali IV 2024<br>Kuartali IV 2025 | 100 | 120 | 150 | 100.000 | 800.000 | 1.000.000 |
| 3. Përpilimi e analizës nga vizitat profesionale | - Njësia për punë | - Sektorë tjerë të Byrosë | Kuartali III 2023<br>Kuartali III 2024 | Kuartali IV 2023<br>Kuartali IV 2024 | 6 | 6 | 6 | | | |

| | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | profesionale-këshilluese | | Kuartali III 2025 | Kuartali IV 2025 | | | | | | |
| 4. Përpilimi i Programeve vjetore për përsosje profesionale të mësimdhënësve, përkatësisht bashkëpunëtorëve profesional të shkollave fillore dhe të mesme | - Njësia për zhvillim profesional | - Sektorë tjerë të Byrosë<br>- këshilltarë të Byrosë<br>- përfaqësues të shkollave fillore dhe të mesme<br>-QATP<br>-ISHA | Kuartali IV 2023<br>Kuartali IV 2024<br>Kuartali IV 2025 | Kuartali I 2024<br>Kuartali I 2025<br>Kuartali I 2026 | 10 | 10 | 10 | | | |
| 5. Zbatimi i aktiviteteve për akreditim të programeve të trajnimit dhe ofruesit e shërbimit për trajnim të mësimdhënësve dhe bashkëpunëtorëve profesional të shkollave fillore dhe të mesme | - Njësia për zhvillim profesional<br>- Komisioni për zgjedhje dhe akreditim të programeve të trajnimit dhe ofruesit e shërbimeve, i formuar nga ana e drejtorit të Byrosë. | -Drejtori i Byrosë | Kuartali I 2023<br>Kuartali I 2024<br>Kuartali I 2025 | Kuartali IV 2023<br>Kuartali IV 2024<br>Kuartali IV 2025 | 10 | 10 | 10 | 6.000.000 | 44.000.000 | 44 000.000 |
| 6. Monitorimi i kryerjes së shërbimeve të institucioneve dhe personave juridik të akredituara, për sa i përket cilësisë dhe performancës së shërbimeve sipas afatitit të caktuar | - Njësia për zhvillim profesional | - Sektorë tjerë të Byrosë | Kuartali III 2023<br>Kuartali III 2024<br>Kuartali III 2025 | Kuartali IV 2023<br>Kuartali IV 2024<br>Kuartali IV 2025 | 30 | 30 | 30 | 100.000 | 200.000 | 200.000 |

| | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 7. Përpilimi, plotësimi, botimi dhe publikimi i Katologut të ofruesve të akredituara të trajnimit dhe shërbimit dhe programeve të trajnimit | - Njësia për zhvillim profesional<br>- sektori për veprimtari botuese | - Sektorë tjerë të Byrosë | Kuartali II 2023<br>Kuartali II 2024<br>Kuartali II 2025 | Kuartali IV 2023<br>Kuartali IV 2024<br>Kuartali IV 2025 | 8 | 8 | 8 | | | |
| 8. Realizimi i aktiviteteve për zhvillim në karrierë të kuadrit edukativ-arsimor | - Njësia për zhvillim profesional | - Sektorë tjerë të Byrosë | Kuartali I 2023<br>Kuartali I 2024<br>Kuartali I 2025 | Kuartali IV 2023<br>Kuartali IV 2024<br>Kuartali IV 2025 | 50 | 50 | 50 | 200.000 | 200.000 | 200.000 |
| **Gjithsej aktivitete në vitin e I: 8** | | | | | | | | 6.400.000 | | |
| **Gjithsej aktivitete në vitin e II: 8** | | | | | | | | | 44.400.000 | |
| **Gjithsej aktivitete në vitin e III: 8** | | | | | | | | | | 44.400.000 |
| **Gjithsej aktivitete të nënprogramit 5: 24** | | | | | | | | 6.400.000 | 21.100.000 | 21.300.000 |

**Nënprogrami 6:** Monitorimi dhe evaluimi i arritjeve të nxënësve dhe mësimdhënësve

| Aktiviteti | Përgjegjës | Konsultuar | Korniza kohore | | Burimet e nevojshme | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | Fillimi (muaji/viti) | Mbarimi (muaji/viti) | Njerëzore | Financiare (MKD) |

| | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1. Krijimi i instrumenteve dhe udhëzuesve për zbatimin e vetëevaluimit | -Njësia për monitorim dhe vlerësim të arritjeve të nxënësve dhe mësimdhënësve | - MASH<br>- ISHA<br>- bashkëpunëtorë të jashtëm | Kuartali I 2023 | Kuartali IV 2023 | Viti I<br>8 | Viti II | Viti III | Viti I | Viti II | Viti III |
| 2. Krijimi i instrumenteve elektronike për vetëevaluim të shkollave | -Njësia për monitorim dhe vlerësim të arritjeve të nxënësve dhe mësimdhënësve | - Sektorë tjerë të Byrosë<br>- ISHA<br>- bashkëpunëtorë të jashtëm | Kuartali I 2023 | Kuartali IV 2023 | | 20 | | | 400.000 | |
| 3. Pilotimi i instrumenteve elektronike për vetëevaluimin e shkollave | -Njësia për monitorim dhe vlerësim të arritjeve të nxënësve dhe mësimdhënësve | - Sektorë tjerë të Byrosë<br>- shkolla bashkëpunëtorë të jashtëm | Kuartali II 2023 | Kuartali I 2024 | 30 | 30 | | | | |
| 4. Realizimi i trajnimit me drejtorët, shërbimin profesional dhe mësimdhënësit për zbatimin e procesit të vetëevaluimit | -Njësia për monitorim dhe vlerësim të arritjeve të nxënësve dhe mësimdhënësve | -Përfaqësues të shkollave fillore dhe të mesme<br>- Sektori i logjistikës<br>- këshilltarë të Byrosë | Kuartali I 2023 | Kuartali IV 2024 | 30 | 30 | | | | |
| 5. Hartimi i Metodologjisë për vlerësim objektiv | -Njësia për monitorim dhe vlerësim të arritjeve të nxënësve dhe mësimdhënësve | - Këshilltarë të Byrosë<br>- bashkëpunëtorë të jashtëm | Kuartali I 2023 | Kuartali IV 2023 | 15 | | | | | |

| | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 6. Realizimi i trajnimeve të mësimdhënësve për vlerësim objektiv | -Njësia për monitorim dhe vlerësim të arritjeve të nxënësve dhe mësimdhënësve | - Sektorë tjerë të Byrosë<br>- QSHP<br>-përfaqësues të shkollave fillore dhe të mesme | Kuartali IV 2023 | Kuartali I 2025 | 35 | 35 | 35 | | | |
| **Gjithsej aktivitete në vitin e I: 6** | | | | | | | | | | |
| **Gjithsej aktivitete në vitin e II: 3** | | | | | | | | | 400.000 | |
| **Gjithsej aktivitete në vitin e III: 1** | | | | | | | | | | |
| **Gjithsej aktivitete të nënprogramit 6: 10** | | | | | | | | | 400.000 | |

| **Nënprogrami 7:** Dokumentacioni dhe evidenca pedagogjike, përmbajtjet digjitale dhe kurset online | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **Aktiviteti** | **Përgjegjës** | **Konsultuar** | **Korniza kohore** | | **Burimet e nevojshme** | | | | | |
| | | | **Fillimi (muaji/viti)** | **Mbarimi (muaji/viti)** | **Njerëzore** | | | **Financiare (MKD)** | | |
| | | | | | Viti I | Viti II | Viti III | Viti I | Viti II | Viti III |
| 1. Përpilimi, lektorimi, përkthimi dhe rregullimi teknik i formulareve për arsimin parashkollor, fillor dhe të mesëm | - Sektori për veprimtari botuese<br>- Njësia për veprimtari botuese dhe dokumentacioni pedagogjik<br>- Njësia për krijimin e përmbajtjeve | - MASH<br>- MPPS<br>- AMPT<br>- QSHP<br>- sektorët e BZHA<br>- ligjërues të autorizuar për gjuhët maqedonase, shqipe, turke, | Kuartali I 2023 | Kuartali IV 2025 | 20 | 20 | 20 | 200.000 | | |

| | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | digjitale dhe kurseve online | serbe dhe boshnjake;<br>- përkthyes të autorizuar për gjuhët turke, serbe dhe boshnjake;<br>- dizajner grafik. | | | | | | | | |
| 2. Botimi dhe distribuimi i formularëve të përpiluar të dokumentacionit dhe evidencës pedagogjike për arsimin fillor dhe të mesëm (në gjuhën maqedone, shqipe, turke, serbe dhe boshnjake) | - Sektori për veprimtari botuese<br>- Njësia për veprimtari botuese dhe dokumentacioni pedagogjik | - Sektorë të BZHA<br>- sektorë të financave<br>- lektorë<br>- përkthyes | Kuartali I 2023 | Kuartali IV 2025 | 35 | 35 | 35 | 8.925.000 | 13.000.000 | 13.000.000 |
| 3. Mbledhja dhe përditësimi i të dhënave nga shkollat fillore dhe të mesme | - Sektori për veprimtari botuese<br>- Njësia për veprimtari botuese dhe dokumentacioni pedagogjik<br>- punonjës tjerë nga NjR të Byrosë | - Përfaqësues të shkollave fillore dhe të mesme | Kuartali IV 2023 | Kuartali IV 2025 | 40 | 40 | 40 | | | |
| 4. Përpilimi dhe miratimi i Plani i botimit | - Këshilli për botim<br>- Sektori për veprimtari botuese | -Udhëheqës të sektorëve të BZHA<br>- sektori i finansave | Kuartali IV 2023 | Kuartali IV 2025 | 15 | 15 | 15 | 50.000 | 200.000 | 200.000 |

| | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | - Njësia për veprimtari botuese dhe dokumentacioni pedagogjik | | | | | | | | | |
| 5. Realizimi i trajnimeve të këshilltarëve të Byrosë për krijimin e përmbajtjeve digjitale | - Njësia për krijimin e përmbajtjeve digjitale dhe kurseve online | - Smart Ap<br>- UNICEF<br>- institucionet që merren me përpunimin e kurseve onlin në vendin tonë dhe më gjerë | Kuartali I 2023 | Kuartali IV 2025 | 80 | 100 | 120 | | | |
| 6. Pasurimi i bibliotekës së Byrosë me literaturë profesionale | - Sektori për veprimtari botuese<br>- Njësia për veprimtari botuese dhe dokumentacioni pedagogjik | - të punësuar në BZHA<br>- BUP „Shën Klimenti i Ohrit “ | Kuartali I 2023 | Kuartali IV 2025 | 2 | 2 | 2 | | | |
| **Gjithsej aktivitete në vitin e I: 6** | | | | | | | | 9.175.000 | | |
| **Gjithsej aktivitete në vitin e II: 6** | | | | | | | | | 13.200.000 | |
| **Gjithsej aktivitete në vitin e III: 6** | | | | | | | | | | 13.200.000 |
| **Gjithsej aktivitete të nënprogramit 7: 18** | | | | | | | | 9.175.000 | 13.200.000 | 13.200.000 |

## 3. NDIKIMI NDAJ BURIMEVE NJERËZORE

| Programi | Rezime e nevojës për punësime të reja | Rezime e nevojës për rishpërndarje të punonjësve | Rezime e nevojës për trajnim |
|---|---|---|---|
| **Programi 1** | Për ekipimin e Byrosë së Zhvillimit të Arsimit, është planifikuar punësim i ri i këshilltarëve sipas Planit vjetor për punësim për vitin 2023, 2024, 2025. | Është e mundur dislokim horizontal dhe vertikal i punonjësve. | Për punë në nivel të lartë profesional, janë planifikuar trajnime të specializuara dhe gjenerike për punonjësit e Byrosë sipas prioriteteve të Byrosë, MASH dhe QRMV, si dhe sipas Planit Vjetor për trajnime të nëpunësve administrativ të MSHIA. |

## 4. PARIMET E PËRFAQËSIMIT TË DREJTË

Në Byronë e Zhvillimit të Arsimit nga aspekti i përfaqësimit të drejtë, nga gjithsej 148 punonjës (pa drejtor dhe zëvendës drejtor), në pozita udhëheqëse nga kombësia maqedonase janë 11, nga kombësia shqiptare janë 4, turke janë 2 dhe kombësi tjetër 1. Në pozita joudhëheqëse nga kombësia maqedonase janë 78, shqiptare 40, turke 11, vllahe 1 dhe boshnjake 1. Që nënkupton se numri i përgjithshëm i pozitave udhëheqëse dhe joudhëheqëse numëron, 89 nga kombësia maqedonase, 43 shqiptare, 13 turke, 1 vllahe, 1 boshnjake dhe 1 kombësi tjetër.

| Pozita e punës | Maqedonase | Shqiptare | Turke | Vllehe | Serbe | Rome | Boshnjake | Tjera |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Udhëheqëse | 11 | 4 | 2 | / | / | / | / | 1 |
| Joudhëheqëse | 78 | 39 | 11 | 1 | / | / | 1 | / |
| Gjithsej | 89 | 43 | 13 | 1 | / | / | 1 | 1 |

| Ndikimi i pritur në vitin 2023 | Ndikimi i pritur në vitin 2024 | Ndikimi i pritur në vitin 2025 |
|---|---|---|
| Procedura e punësimit do të zbatohet sipas Planit vjetor për punësim dhe Balancuesit me të gjitha alokimet e mundshme të personave të rinj të punësuar me përfaqësim adekuad të komuniteteve të cilët nuk janë shumicë në RMV. | Procedura e punësimit do të zbatohet sipas Planit vjetor për punësim dhe Balancuesit me të gjitha alokimet e mundshme të personave të rinj të punësuar me përfaqësim adekuad të komuniteteve të cilët nuk janë shumicë në RMV. | Procedura e punësimit do të zbatohet sipas Planit vjetor për punësim dhe Balancuesit me të gjitha alokimet e mundshme të personave të rinj të punësuar me përfaqësim adekuad të komuniteteve të cilët nuk janë shumicë në RMV. |

## 5. PARIMI I MUNDËSIVE TË BARABARTA TË GRAVE DHE BURRAVE

Në Byronë e Zhvillimit të Arsimit nga aspekti i barazisë gjinore, nga gjithsej 148 punonjës, 54 janë burra dhe 94 janë gra. Kështu që, nga gjithsej 18 nëpunës administrativ udhëheqës me arsim të lartë, 5 janë burra dhe 13 janë gra, ndërsa nga gjithsej 130 nëpunës administrativ joudhëheqës 49 janë burra dhe 81 janë gra, nga të cilët me arsim të lartë 37 janë burra dhe 69 janë gra, derisa, me arsim të mesëm 11 janë burra dhe 11 janë gra, ndërsa me arsim fillor 1 burrë dhe 1 grua.

| Pozita e punës | I lartë | | Sipëror | | I mesëm | | Fillor | | GJITHSEJ | | Gjithsej punonjës të organit |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | Burra | Gra | Burra | Gra | Burra | Gra | Burra | Gra | Burra | Gra | |
| Udhëheqëse | 5 | 13 | | | | | | | 5 | 13 | 18 |
| Jo udhëheqëse | 37 | 69 | | | 11 | 11 | 1 | 1 | 49 | 81 | 130 |
| Gjithsej | 42 | 82 | | | 11 | 11 | 1 | 1 | 54 | 94 | 148 |

| Ndikimi i pritur në vitin 2023 | Ndikimi i pritur në vitin 2024 | Ndikimi i pritur në vitin 2025 |
|---|---|---|
| Gjatë punësimeve të reja në Byro do të merret parasysh zbatimi i kritereve për mundësi të barabarta të grave dhe burrave sipas Ligjit për mundësi të barabarta të grave dhe burrave (barazia gjinore). | Gjatë punësimeve të reja në Byro do të merret parasysh zbatimi i kritereve për mundësi të barabarta të grave dhe burrave sipas Ligjit për mundësi të barabarta të grave dhe burrave (barazia gjinore). | Gjatë punësimeve të reja në Byro do të merret parasysh zbatimi i kritereve për mundësi të barabarta të grave dhe burrave sipas Ligjit për mundësi të barabarta të grave dhe burrave (barazia gjinore). |

## 6. ZHVILLIMI I FUNKSIONEVE TË PËRBASHKËTA

### Zhvillimi i politikave

Në funksion të krijimit të politikave, gjegjësisht akteve ligjore dhe dokumenteve në juridiksionin e Byrosë, është institucionalizuar Sektori i logjistikës, në kuadër të së cilës në mënyrë organizative funksionojnë: Njësia e punëve normative-juridike dhe punë të zyrës dhe Njësia për furnizime publike dhe punë të përgjithshme.

Për të forcuar koordinimin, komunikimin dhe bashkëpunimin e brendshëm, shpesh zbatohet qasja e formimit të grupeve dhe komisioneve të punës me përfshirjen e përfaqësuesve të njësive organizative relevante të Byrosë dhe palëve të interesit.

| Ndikimi i pritur në vitin 2023 | Ndikimi i pritur në vitin 2024 | Ndikimi i pritur në vitin 2025 |
|---|---|---|
| - Ndryshime dhe plotësime/miratimi i Ligjit të ri të Byrosë së Zhvillimit të Arsimit;<br>- Ndryshime dhe plotësime të Rregullores për organizim dhe sistemim të brendshëm;<br>- Përgatitja e akteve nënligjore sipas ligjeve të sistemit;<br>- Ngritja e kapaciteteve të Sektorit të logjistikës për krijim dhe koordinim të politikave të Byrosë. | -Trajnime të specializuara lidhur me forcimin e kapaciteteve gjatë përgatitjes së akteve ligjore dhe dokumenteve nën juridiksionin e Byrosë. | -Trajnime të specializuara lidhur me forcimin e kapaciteteve gjatë përgatitjes së akteve ligjore dhe dokumenteve nën juridiksionin e Byrosë. |

**Planifikimi strategjik/ përgatitja e buxhetit**

Draft-plani strategjik i Byrosë hartohet nga grupi i punës i krijuar nga drejtori. Koordinimin e finalizimit të Planit strategjik dhe përgatitja e Planit vjetor të punës së Byrosë është në përgjegjësi të Njësisië për planifikim strategjik, krijim të politikave dhe monitorim.
Gjatë hartimit të planit strategjik konsultohet Sekretariati Gjeneral i Qeverisë së RMV.
Zbatimi koordinohet nga drejtori.
Qarkorja buxhetore sipas aktiviteteve të planifikuara më parë nga plani strategjik, përgatitet nga Sektori për çështje financiare në kuadër të së cilës në mënyrë organizative funksionojnë: Njësia për koordinim të buxhetit, Njësia e kontrollit të buxhetit dhe Njësia e kontabilitetit dhe pagesave.

| Ndikimi i pritur në vitin 2023 | Ndikimi i pritur në vitin 2024 | Ndikimi i pritur në vitin 2025 |
|---|---|---|
| - Ngritja e kapaciteteve për krijim, koordinim dhe harmonizim të Planit strategjik dhe Planit vjetor të Byrosë duke punësuar përmbarues të rinj;<br>- Ngritja e kapaciteteve për sigurimin e konsistencës së prioriteteve dhe qëllimeve të Byrosë me prioritetet dhe qëllimet e MASH dhe të QRMV;<br>- Ngritja e kapaciteteve për ndërlidhjen e aktiviteteve të planifikuara me planin buxhetor të Byrosë. | - Ngritja e kapaciteteve për përgatitjen e treguesve për matjen e zbatimit të Planit strategjik të Byrosë dhe zhvillimin e kapaciteteve për monitorimin e treguesve;<br>- Trajnime të specializuara në lidhje me forcimin e kapaciteteve gjatë përgatitjes së buxhetit të Byrosë, sidomos në pjesën e përgatitjes së kornizës buxhetore afatmesme (planifikimi dyvjetor i buxhetit) si dhe monitorimin e tij;<br>- Trajnime të specializuara për tu lidhur me prioritetet afatmesme të planit strategjik. | - Ngritja e kapaciteteve për përgatitjen e treguesve për matjen e zbatimit të Planit strategjik të Byrosë dhe zhvillimin e kapaciteteve për monitorimin e treguesve;<br>- Trajnime të specializuara në lidhje me ngritjen e kapaciteteve gjatë përgatitjes së buxhetit të Byrosë, sidomos në pjesën e përgatitjes së kornizës buxhetore afatmesme (planifikimi dyvjetor i buxhetit) si dhe monitorimin e tij;<br>- Trajnime të specializuara për tu lidhur me prioritetet afatmesme të planit strategjik. |

**Realizimi i buxhetit dhe menaxhimi me mjetet**

Sektori për çështje financiare me njësitë brenda saj është përgjegjës për përgatitjen e propozim kërkesën buxhetore dhe ekzekutimin e buxhetit të miratuar të Byrosë në koordinim, komunikim dhe bashkëpunim me sektorët/njësitë e Byrosë së Zhvillimit të Arsimit.

| Ndikimi i pritur në vitin 2023 | Ndikimi i pritur në vitin 2024 | Ndikimi i pritur në vitin 2025 |
|---|---|---|
| - Ngritja e kapaciteteve të Sektorit për çështje financiare;<br>-Ngritja e kapaciteteve të Sektorit për çështje financiare me trajnime shtesë dhe të specializuara të punonjësve në lidhje me operacionet e thesarit për monitorimin e të gjitha ndryshimeve në operacionet e thesarit;<br>- Trajnime të specializuara për ngritjen e kapaciteteve të Byrosë për kryerjen e operacioneve financiare-materiale dhe furnizimeve publike;<br>-Përmirësim i vazhdueshëm i sistemit të politikave, procedurave dhe aktiviteteve lidhur me menaxhimin financiar dhe kontrollin. | - Trajnime të specializuara për ngritjen e kapaciteteve të Byrosë për kryerjen e operacioneve financiare-materiale dhe furnizimeve publike;<br>- Përmirësim i vazhdueshëm i sistemit të politikave, procedurave dhe aktiviteteve lidhur me menaxhimin financiar dhe kontrollin. | - Trajnime të specializuara për ngritjen e kapaciteteve të Byrosë për kryerjen e operacioneve financiare-materiale dhe furnizimeve publike;<br>-Përmirësim i vazhdueshëm i sistemit të politikave, procedurave dhe aktiviteteve lidhur me menaxhimin financiar dhe kontrollin. |

**Menaxhimi i burimeve njerëzore**

Menaxhimi i burimeve njerëzore është në përgjegjësi të Njësisë së menaxhimit të burimeve njerëzore, në koordinim, komunikim dhe bashkëpunim me sektorët/njësitë e Byrosë së Zhvillimit të Arsimit.

| Ndikimi i pritur në vitin 2023 | Ndikimi i pritur në vitin 2024 | Ndikimi i pritur në vitin 2025 |
|---|---|---|
| - Ngritja e kapaciteteve të Njësisë së menaxhimit të burimeve njerëzore;<br>- Ngritja e integritetit dhe përgjegjësisë së punonjësve dhe nëpunësve administrativ të Byrosë së Zhvillimit të Arsimit;<br>- Punësimi i stafit profesional, cilësor dhe konkurrues;<br>- Avancimi në karrierë të nëpunësve administrativ. | - Forcimi i kompetencave dhe përgjegjësive të punonjësve dhe nëpunësve administrativ përmes selektimit objektiv dhe transparent të bazuar në kompetenca;<br>- Trajnimi dhe zhvillimi i vazhdueshëm profesional, avancimi në karrierë dhe ndërtimi i një atmosfere pune të motivuar. | - Forcimi i kompetencave dhe përgjegjësive të punonjësve dhe nëpunësve administrativ përmes selektimit objektiv dhe transparent të bazuar në kompetenca;<br>- Trajnimi dhe zhvillimi i vazhdueshëm profesional, avancimi në karrierë dhe ndërtimi i një atmosfere pune të motivuar. |

**Menaxhimi me teknologjinë e informacionit**

Në Byronë e Zhvillimit të Arsimit nuk është institucionalizuar një formë e veçantë organizative (sektor apo njësi) për menaxhimin me teknologjinë e informacionit. Për përmirësimin dhe mirëmbajtjen e infrastrukturës TIK kujdesen punonjës me arsimim të përshtatshëm nga sektorë/njësi të tjera.

| Ndikimi i pritur në vitin 2023 | Ndikimi i pritur në vitin 2024 | Ndikimi i pritur në vitin 2025 |
|---|---|---|
| - Ngritja e kapacitetit të Byrosë përmes trajnimeve të specializuara nga TIK;<br>- Mirëmbajtje institucionale të sistemeve; | - Ngritja e kapacitetit të Byrosë përmes trajnimeve të specializuara nga TIK;<br>- Mirëmbajtje institucionale të sistemeve; | - Ngritja e kapacitetit të Byrosë përmes trajnimeve të specializuara nga TIK;<br>- Mirëmbajtje institucionale të sistemeve; |

| | | |
|---|---|---|
| - Krijimi i sistemeve të reja të informacionit për mbështetjen e procesit të integrimit;<br>- Krijimi i bazave të reja të të dhënave dhe sigurimi i qëndrueshmërisë së bazave ekzistuese;<br>- Kujdesi për sigurinë e të dhënave brenda infrastrukuturës së TIK-ut;<br>- Rikonstruksioni i infrastrukturës së informacionit, rrjetit dhe pajisjeve të Byrosë. | - Krijimi i sistemeve të reja të informacionit për mbështetjen e procesit të integrimit;<br>- Krijimi i bazave të reja të të dhënave dhe sigurimi i qëndrueshmërisë së bazave ekzistuese;<br>- Kujdesi për sigurinë e të dhënave brenda infrastrukuturës së TIK-ut;<br>- Rikonstruksioni i infrastrukturës së informacionit, rrjetit dhe pajisjeve të Byrosë;<br>- Konsolidimi i infrastruktirës së informacionit, futja dhe monitorimi i politikave strikte të sigurisë;<br>- Përgatitja e një koncepti dhe modeli të dhënash të një platforme për monitorimin e telekonferencave. | - Krijimi i sistemeve të reja të informacionit për mbështetjen e procesit të integrimit;<br>- Krijimi i bazave të reja të të dhënave dhe sigurimi i qëndrueshmërisë së bazave ekzistuese;<br>- Kujdesi për sigurinë e të dhënave brenda infrastrukuturës së TIK-ut;<br>- Rikonstruksioni i infrastrukturës së informacionit, rrjetit dhe pajisjeve të Byrosë;<br>- Konsolidimi i infrastruktirës së informacionit, futja dhe monitorimi i politikave strikte të sigurisë;<br>- Përgatitja e një koncepti dhe modeli të dhënash të një platforme për monitorimin e telekonferencave. |
| **Revizioni i brendshëm**<br>Në vitin 2019 është institucionalizuar Njësia e revizionit të brendshëm të Byrosë së Zhvillimit të Arsimit me një përmbarues me titull bashkëpunëtorë më i ri. | | |
| **Ndikimi i pritur në vitin 2023** | **Ndikimi i pritur në vitin 2024** | **Ndikimi i pritur në vitin 2025** |
| - Ngritja e kapaciteteve të Njësisë së revizionit të brendshëm me punësimin e përmbaruesve të rinj | - Përgatitja e Planit vjetor për punë të njësisë për revizionit të brendshëm;<br>- Revizione sipas planit dhe ad-hoc revizione me kërkesë të udhëheqësisë; | - Përgatitja e Planit vjetor për punë të njësisë për revizionit të brendshëm;<br>- Revizione sipas planit dhe ad-hoc revizione me kërkesë të udhëheqësisë; |

| | | |
|---|---|---|
| - Përgatitja e Planit vjetor për punë të njësisë për revizionit të brendshëm;<br>- Ndjekja e trajnimeve për përmirësimin e kapaciteteve të personelit në njësinë për revizion të brendshëm. | - Ndjekja e trajnimeve për përmirësimin e kapaciteteve të personelit në njësinë për revizion të brendshëm. | - Ndjekja e trajnimeve për përmirësimin e kapaciteteve të personelit në njësinë për revizion të brendshëm. |

## 7. RREZIQET NË NIVEL TË PLANIT STRATEGJIK

| RREZIK | PROBABILITETI I RREZIKUT | NDIKIMI I RREZIKUT NË ARRITJEN E QËLLIMEVE | MASAT E MENAXHIMIT TË RREZIKUT |
|---|---|---|---|
| Sigurimi i ulët i burimeve (njerëzore, financiare, materiale dhe infrastrukturore) | I madh | I madh | Punësimi i përmbaruesve të rinj sipas Planit Vjetor të Punësimit;<br>Sigurimi i burimeve financiare nga MF në bazë të propozim buxhetit të Byrosë |
| Dështimi funksional i serverit dhe pajisjeve aktive të rrjetit për shkak të:<br>-defektit/jofunsionalitetit të pajisjes së TIK-ut;<br>- ndërprerjes së plotë të sistemit TIK;<br>- humbjes së përhershme të të dhënave; | I mesëm | I mesëm | Furnizim i vazhdueshëm i pajisjeve bashkëkohore të TIK-ut |

| | | | |
|---|---|---|---|
| - mungesës së një burimi shtesë të energjisë elektrike;<br>- fatkeqësive natyrore. | | | |
| Masat dhe protokollet e zbatuara gjatë pandemisë | I mesëm | I vogël | Përshtatja e një pjese të aktiviteteve sipas kushteve të krijuara nga pandemia |
| Organizimi, koordinimi dhe menaxhimi i papërshtatshëm | I vogël | I mesëm | Mbajtja e takimeve profesionale dhe takimeve për punë si dhe krijimi i planeve të veprimit me elementet dhe burimet e nevojshme |

## 7.1 RREZIQET NË NIVEL TË PROGRAMIT 1

| RREZIK | PROBABILITETI I RREZIKUT | NDIKIMI I RREZIKUT NË ARRITJEN E QËLLIMEVE | MASAT E MENAXHIMIT TË RREZIKUT |
|---|---|---|---|
| Mosmiratimi i të gjitha llogaritjeve të listuara dhe kërkesave të dorëzuara në MF për realizimin e aktiviteteve të planifikuara | I madh | I madh | Në procesin e harmonizimit, prioritet u jepet aktiviteteve që tashmë janë duke u zhvilluar dhe atyre që kanë rëndësi strategjike |
| Numri i pamjaftueshëm i punonjësve për realizimin e detyrave dhe obligimeve të caktuara | I madh | I madh | Ekipimi i Byrosë me burime njerëzore |
| Mungesa e mbështetjes buxhetore për punësime të reja | I madh | I madh | Hartimi i Analizës Funksionale për nevojat reale të vendeve të reja të punës dhe financimi i tyre |

| | | | |
|---|---|---|---|
| Mungesa e interesimit nga ofruesit e shërbimeve për pjesëmarrje në shpalljen e furnizimeve publike, konkurset, shpalljet etj. | I madh | I madh | Shpallje e sërishme |
| Pamundësia e realizimit të detyrave të planifikuara të punës për shkak të detyrave të tjera prioritete jo programore të Byrosë | I mesëm | I vogël | Rishpërndarja e detyrave të punës punonjësve në Byro |
| Mos respektimi afatit kohor për dorëzimin e të dhënave nga institucionet dhe palët e interesit | I mesëm | I mesëm | Vërejtje më të shpeshta për institucionet dhe palët e interesit për afatet e dorëzimit të të dhënave të kërkuara |
| Masat dhe protokollet e zbatuara gjatë pandemisë | I mesëm | I vogël | Përdorimi optimal i sistemit online me fokus më të madh në zgjidhjet inovative |
| Vonesa/moszbatimi i aktiviteteve brenda periudhës së planifikuar | I vogël | I vogël | Rishpërndarja e detyrave të punës punonjësve në Byro |